**- P R O J E K T -**

# LIGJ

**Nr. ------ date------------**

# PËR PROCEDURAT TATIMORE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

## KREU I
## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

### Neni 1
### Objekti i Ligjit

1) Ky ligj rregullon procedurat për administrimin e detyrimeve tatimore në Republikën e Shqipërisë si dhe parimet e organizimit dhe të funksionimit të administratës tatimore në Republikën e Shqipërisë.

2) Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të gjitha llojet e tatimeve dhe detyrimeve tatimore, me përjashtim të rasteve kur ligji i veçante e ka parashikuar ndryshe.

### Neni 2
### Fusha e veprimit

1) Ky ligj zbatohet për:

a. tatimpaguesit, administraten tatimore, agjentët tatimorë, agjentet e mbajtjes se tatimit ne burim si dhe per persona të tjerë të përcaktuar sipas legjislacionit tatimor;
b. personat e ngarkuar per te paguar, mbajtur, deklaruar dhe transferuar ne buxhetin e shtetit, kontributet per sigurimet shoqerore dhe shendetesore;
c. paguesit e kontributeve per sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sa i perket pageses dhe mbledhjes se kontributeve;

d. sistemin e tatimeve dhe taksave vendore, për aq sa nuk rregullohen me ligjin nr. 9632, date 30.10.2006, “Per sistemin e taksave vendore”.

**Neni 3**
**Legjislacioni tatimor**

1) Legjislacioni tatimor perbehet nga:
a. marreveshjet nderkombetare te ratifikuara nga Kuvendi i Republikes se Shqiperise;
b. ligjet tatimore;
c. aktet nen ligjore te miratuara ne mbeshteteje te ligjeve tatimore.

**Neni 4**
**Llojet e tatimeve dhe taksave**

1) Tatimet dhe taksat jane kombetare ose vendore.
2) Ne tatimet dhe taksat kombetare perfshihen:
a. tatimi mbi vleren e shtuar;
b. tatimi mbi te ardhurat;
c. akciza;
d. tatimi per lojrat e fatit, kazinote dhe hipodromet;
e. taksat kombetare;
f. tatime te tjera te cilat jane percaktuar si te tilla me ligj te veçante.
3) Tatimet dhe taksat vendore, përcaktohen ne ligjin per sistemin e taksave vendore.
4) Kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore përcaktohen ne ligjin per sigurimet shoqerore dhe shendetesore.

**Neni 5**
**Perkufizime**

1) Ne zbatim te ketij ligji fjalet e meposhteme kane keto kuptime:
“administrate tatimore”; për tatimet, taksat dhe kontributet kombëtare, është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), Drejtorite Rajonale dhe njesite e ngjashme me to; për tatimet, taksat ose kontributet vendore, jane njësitë tatimore të qeverisjes vendore;
„agjent tatimor“ eshte personi qe transferon ne buxhetin e shtetit, tatimet dhe taksat e mbedhura;
“agjent i mbajtjes se tatimit ne burim” eshte personi, te cilit sipas legjislacionit tatimor i kërkohet të llogarisë, të mbajë tatimin në burim për një tatimpagues, të raportojë si dhe t’i transferoje këto tatime në buxhetin e shtetit;
“kontribut” eshte detyrim monetar i detyrueshem per t’u paguar si shperblim per nje sherbim specifik apo ushtrim te te drejtave per sigurimin shoqeror dhe shendetesor te te punësuarve;
“libra dhe rregjistrime” janë regjistrimet tregtare, dokumentacioni kontabël, llogaritë vjetore dhe raportet financiare si edhe gjithë

dokumentet e tjera që kanë të bëjnë me subjektin tatimpagues, korrespondencën e biznesit, faturat dhe gjithë dokumentet e tjera përkatëse që duhen krijuar dhe mbajtur për përcaktimin e shumave të tatimeve që duhen paguar nga tatimpaguesi;

"periudhe tatimore" me perjashtim te rasteve kur ky ligj ose ligje te tjera tatimore parashikojne ndryshe, eshte periudha e njejte me vitin kalendarik

"perfaqesues i tatimpaguesit" është personi i autorizuar ligjërisht për të përfaqësuar tatimpaguesin në çeshtje tatimore;

"tatim" eshte pagese e detyrueshme dhe e pakthyeshme ne buxhetin e shtetit apo ne buxhetin e organeve te pushtetit vendor, e vendosur me ligj dhe qe nuk behet ne shkembim te mallrave dhe sherbimeve te caktuara;

"taksa" eshte pagese e detyrueshme dhe e pakthyeshme ne buxhetin e shtetit apo ne buxhetin e organeve te pushtetit vendor, e vendosur me ligj dhe qe paguhet nga cdo person qe ushtron nje te drejte publike apo perfiton nje sherbim publik ne territorin e republikes se shqiperise. Dispozitat e ketij ligji per tatimet dhe detyrimet tatimore, zbatohen njesoj edhe per taksat;

"tatimpagues" eshte personi apo individi, i cili detyrohet nga ligji te paguaje tatime, taksa ose kontribute te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore dhe perfshin dhe agjentin e mbajtjes se tatimit ne burim;

"vend kryesor i biznesit" është vendi i administrimit efektiv të biznesit;

„person i lidhur" me tatimpaguesin do te konsiderohen sipas rastit:

- personat me te cilet eshte lidhur nje ose me shume marrveshje biznesi;
- kontrolluesi apo i kontrolluari prej tij;
- ne rastin e individit tregtar, individet qe kane lidhje gjaku deri ne shkallen e dyte;
- individet qe ushtrojne detyra drejtuese ne organizimin e me shume se nje tregtari;
- individet qe kane marredhenie punesimi edhe me tatimpagues te tjere.

## Neni 6
## Detyrimi tatimor

1) Detyrimi tatimor lind edhe kur personi realizon te ardhura, kryen pagesa ne forme te jashtëligjshme apo behet zoterues i nje sendi ne forma te jashteligjshme. Kur personi behet pronar i nje sendi ne forma te jashteligjshme, ky detyrim perllogaritet per te gjithe peridhen ne te cilen personi ka gezuar frytet e asaj pasurie.

2) Detyrimi tatimor perfshin tatimin, kamatvonesat si dhe gjobat per rastet e parashikuara nga ky ligj.

3) Detyrimi tatimor lind kur personi realizon te ardhura, kur behet pronar i nje pasurie apo kryen pagesa, te cilat jane subjekt i tatimit sipas legjislacionit tatimor.

4) Detyrimi tatimor për individë të vdekur ose shoqëri të likuiduara përcaktohet si vijon:

a) në rastin e një personi të vdekur, detyrimi tatimor pushon në datën e vdekjes dhe trashëgimtarët ligjorë janë përgjegjës për llogaritjen dhe pagesën e tatimeve të personit të vdekur;
b) në rastin e një personi juridik të likuiduar, detyrimi tatimor pushon në datën e likuidimit dhe likuidatori ose përfaqësuesi i caktuar ligjërisht është përgjegjës për llogaritjen dhe pagesën e tatimit të këtij personi.

5) Detyrimet tatimore llogariten dhe paguhen ne leke, perveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.

**Neni 7**
**Te drejtat dhe detyrimet e agjentit te mbajtjes së tatimit**

1) Me përjashtim të rastit kur ligji e përcakton ndryshe, agjenti i mbajtjes së tatimit ka të njëjtat të drejta dhe detyrime me një tatimpagues.

2) Agjenti i mbajtjes së tatimit ka detyrat plotësuese si vijon:

a. të llogarisë saktësisht dhe të mbajë në burim tatimin për një tatimpagues;
b. të paguajë tatimin në burim në Buxhetin e Shtetit në datën e përcaktuar në ligj;
c. të mbajë regjistrime për të ardhurat e paguara dhe për tatimet e mbajtura në burim të gjithë tatimpaguesve, dhe të pagesave të transferuara në buxhetin e shtetit;
d. t'i japë administratës tatimore informacion të saktë për deklaratat e tatimpaguesve në datën e duhur të përcaktuar në ligj si dhe
e. të kryejë të gjitha detyrat e tjera te parashikuara nga dipozitat ligjore ne fuqi.

**Neni 8**
**Tatimpaguesi rezident dhe jo-rezident**

1) Tatimpagues rezident eshte:

a. individi i cili:

i) ka nje vendbanim ne Republiken e Shqiperise ne kuptim te nenit 12 te Kodit Civil;
ii) ka nenshtesi shqiptare dhe eshte funksionar diplomatik ose kryen nje funksion te ngjashem ne emer te Republikes se Shqiperise jashte territorit te saj; ose
iii) individi qe ne menyre te vazhdueshme ose me ndërprerje , qendron ne Republiken e Shqiperise me teper se 183 dite ne nje periudhe prej 365;

b. personi juridik i cili:

i) eshte rregjistruar si person juridik shqiptar; ose
ii) ka vendin e administrimit efektiv te veprimtarise ne Republiken e Shqiperise; si dhe

c.personi fizik, i cili, eshte rregjistruar me kete cilësi ne baze te legjislacionit shqiptar ne organin kompetent.

2) Tatimpaguesi qe nuk ploteson te pakten njerin nga parashikimet e paragrafit te pare te ketij neni, eshte tatimpagues jo-rezident.

**Neni 9**
**Caktimi i perfaqesuesi tatimor**
**te personave jo-rezidente**

1) Tatimpaguesi jo-rezident emëron një përfaqësues tatimor rezident dhe rregjistrohet prane qendres kombetare te rregjistrimit, kur kjo i kerkohet nga legjislacioni ne fuqi.

2) Tatimpaguesi jo-resident mund te mos emeroje perfaqesues tatimor ne rastet kur:

a. të gjithat të ardhurave me burimetnë Shqipëri jane subjekt i tatimit perfundimtar te mbajtur në burim ose
b. tatimpaguesi dorëzon vetë deklaratë tatimore.

**Neni 10**
**Udhezimet teknike**

1) Ministri i Finacave miraton udhezim te pergjithshem per zbatimin e legjislacionit tatimor.

2) Drejtori i pergjithshem i tatimeve, me kerkese te tatimpaguesit, mund te nxjerre vendim ne lidhje me qendrimin zyrtar te administrates tatimore ne lidhje me zbatimin e legjislationit tatimor ne rrethanat specifike te ketij tatimpaguesi. Vendimi eshte detyrues per administraten dhe tatimpaguesin qe ka bere kerkesen dhe publikohet brenda 5 diteve kalendarike, duke ruajtur te drejten e konfidencialitetit te te dhenave te biznesit te tatimpaguesit. Vendimi behet detyrues per tatimpaguesin ne daten qe merr njoftim per te ne nje nga format e parashikuara ne Kodin e Procedurave Administrative dhe zbatohet njesoj edhe per raste te tjera te ngjashme.

**Neni 11**
**Negocimi i marrëveshjeve ndërkombëtare**

1) Ministri i financave, eshte sipas rastit, autoritet nenshkrues apo pale ne negociatat qe zhvillohen per te gjitha marrëveshjet nderkombetare qe kane efekte tatimore.

2) Autoriteti nënshkrues dhe miratues i këtyre marrëveshjeve vepron në përputhje me ligjin “Për Lidhjen e Marrëveshjeve dhe Traktateve Ndërkombëtare.”

**KREU II**
**PARIMET, ORGANIZIMI DHE PERSONELI**
**I ADMINISTRATES TATIMORE**

**Neni 12**

**Parimet e administrimit tatimor**

1) Në administrimin e sistemit tatimor të Republikës së Shqipërisë, administrata tatimore udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

a) respektimi i legjislacionit tatimor dhe nxitjen e respektimit vullnetar të ligjit nëpërmjet vetë-vlerësimit të tatimpaguesit;
b) vetë-vlerësimi i tatimpaguesit dhe respektimi i ligjit nepermjet një programi gjithëpërfshirës për informimin dhe edukimin e publikut, zbatimin e njejte, të ndershëm dhe efektiv të ligjit, publikimin e akteve nënligjore dhe akteve normative si dhe aplikimin e sistemeve dhe procedurave administrative të thjeshta;
c) kur respektimi i ligjit nuk arrihet vullnetarisht, në strategjinë dhe masat përkatëse që ndërmerren për pakësimin e këtyre rreziqeve, administrata tatimore identifikon dhe trajton rrezikun që rezulton nga mosrespektimi i ligjit;
d) administrata tatimore bashkëpunon me organet tatimore vendase dhe ndërkombëtare ne funksion te globalizimit të ekonomive botërore;
e) administrata tatimore ndjek ndryshimet në mjedisin e biznesit dhe atë legjislativ, dhe përshtat sistemet e organizimit, burimeve, teknologjisë së informacionit dhe proceseve të punës për arritjen e efiçiencës dhe efektivitetit të duhur;
f) administrata tatimore do të nxise veprimtarite elektronike, sidomos deklarimin dhe pagesën elektronike të detryimit tatimor;
g) administrata tatimore rekruton trajnon dhe ngre në detyrë punonjës tatimorë që janë të ndershëm, të sjellshëm dhe të drejtë, dhe që për çdo rast zbatojnë ligjin, aktet nënligjore dhe vendimet në bazë të fakteve objektive.

**Neni 13**
**Organizimi i administrates tatimore**

1) Administrata tatimore përbëhet nga:

h) administrata tatimore qendrore ne te cilen perfshihet drejtoria e pergjithshme, drejtorite rajonale dhe njesite e tjera te saj.
i) dhe administrata tatimore vendore ne te cilen perfshihen zyrat tatimore nen autoritetin e qeverisjes vendore.

2) Administrata tatimore qendrore eshte institucion qendror ne varesi te ministrit te financave.

**Neni 14**
**Drejtoria e pergjithshme,**
**drejtorite rajonale dhe njesite e tjera**

1) Drejtoria e pergjithshme e tatimeve eshte autoriteti tatimor qendror i vetem ne Republiken e Shqiperise qe zbaton dhe administron tatimet kombetare, pagesat publike dhe mbledhjen e kontributeve siç parashikohet ne nenin 4 te ketij ligji.

2) Drejtoria rajonale varet nga drejtori i pergjithshem i tatimeve.

3) Drejtoria rajonale drejtohet nga drejtori i drejtorise rajonale.

4) Njesi e ngjashme me drejtorine rajonale eshte njesia brenda struktures se administrates tatimore qendrore, e cila ne perputhje me strukturen dhe me pershkrimin e punes, ka organizim dhe funksion te njejte ose te ngjashem me ate te drejtorise rajonale.

**Neni 15**
**Zyrat tatimore te qeverisjes vendore**

1) Zyrat tatimore te qeverisjes vendore funksionojne ne baze te ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “Per sistemin e taksve vendore dhe administrojne taksat, detyrimet tatimore dhe pagesat publike vendore.

2) Dispozitat e ketij ligji qe rregullojne administraimin e taksave detyrimeve dhe pagesave publike vendore, zbatohen nga organet tatimore te qeverisjes vendore.

**Neni 16**
**Struktura e administrates tatimore qendrore**

1) Struktura organizative dhe numri i pergjithshem i personelit te administrates tatimore, miratohet nga Kryeministri me propozim te ministrit te financave.

2) Organigrama e administrates tatimore qendrore miratohet nga Ministri i Financave me propozim te drejtorit te pergjithshem te tatimeve.

3) Administrata tatimore qendrore është e organizuar në drejtori sipas funksioneve që vijojnë:

a) shërbimi dhe rdukimi i tatimpaguesve;
b) kontrolli tatimor;
c) apelimit;
d) mbledhja e detyrimeve tatimore dhe zbatimi i masave shtrenguese;
e) hetimi tatimor;
f) funksionet mbështetëse, duke përfshirë financën dhe statistikat, teknologjinë e informacionit dhe kontrollin e brendshëm, shërbimet ligjore, administratën dhe burimet njerëzore dhe hartimin e rregullave teknike.

4) Drejtoria e apelimit është një njesi e pavarur brenda administratës tatimore qendrore.

5) Funksionet dhe detyrat e drejtorisë së përgjithshme të tatimeve, drejtorive rajonale, te njesive te ngjashme me to, te secilës drejtori si dhe te njesive te tjera te administrates tatimore qendrore, përcaktohen me rregullore të brendshme, e cila propozohet nga drejtori i përgjithshem i tatimeve dhe miratohet nga Ministri i Financave.

6) Ministri i Financave mund te vendose qe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, të nënkontraktohen subjekte private te specializuara për realizimin e funksioneve të parashikuara në paragrafin e trete të këtij neni.

**Neni 17**
**Emrimi i drejtori dhe**
**zevendesdrejtorit te pergjithshem te tatimeve**

1) Organ drejtues i administrates tatimore qendrore eshte drejtori i pergjithshem.
2) Drejtori i pergjithshem i tatimeve emerohet nga Kryeministri me propozim te ministrit te financave.
3) Zevendrejtoret e pergjithshem te tatimeve emrohen nga ministri i financave me propozim te drejtorit te pergjithshem te tatimeve.

**Neni 18**
**Drejtoria e apelimit tatimor**

1) Drejtoria e apelimit tatimor eshte njesi e pavarur brenda administrates tatimore qendrore. Drejtori i drejtorise se apelimit tatimor emerohet nga Ministri i Financave.

**Neni 19**
**Emërimi i personelit**

1) Nëpunësit drejtues dhe specialistë të administratës tatimore gezojne statusin e nepunesit civil dhe per marrdhenien e punesimit te tyre zbatohet legjislacioni i nëpunësit civil për institucionet e pavarura.
2) Procedurat e rekrutimit kryhen nga drejtoria e personelit ne drejtorine e pergjithshme te tatimeve.
3) Marrëdhëniet juridike të punës për punonjësit e administratës tatimore qe nuk kane statusin e nepunesit civil, rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

**Neni 20**
**Punesimi dhe kategorite e punesimit**

1) Drejtori i përgjithshëm i tatimeve merr masat për respektimin e dispozitave ligjore ne lidhje me rekrutimin, levizjen paralele dhe ngritjen ne detyre te nepunesve dhe punonjesve te tjere në drejtorinë e përgjithshme të tatimeve dhe në drejtorite rajonale.
2) Në organikë, personeli ndahet sipas detyrave, në punonjës të nivelit të lartë, të mesëm e të ulët drejtues dhe në punonjës ekzekutues të kategorizuar në aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji.
3) Nivelet e pagave per çdo kategori si dhe proçedurat dhe afatet e kalimit nga një nivel me i ulët në një nivel më të lartë karriere, miratohen nga Keshilli i Ministrave me propozim te ministrit te financave.

**Neni 21**
**Shpërblimet e personelit**

1) Personelit të administratës tatimore qendrore, i njihen shpërblime stimuluese, sipas kritereve të mëposhtëme:

a. shërbimi i kryer në organet tatimore;
b. shërbime me rrezik të veçantë për personin.

2) Drejtori i përgjithshem i tatimeve, miraton funksionet te cilat trajtohen si me rrezik te veçante per personin e punesuar si shperblimin e parashikuar ne paragrafin e pare te ketij neni.

3) Ministri i Financave miraton udhezimin per rregullat qe ndjek drejtori i pergjithshem ne dhenien e shperblimeve.

### Neni 22
### Procedura disiplinore

1) Drejtori i përgjithshëm i tatimeve shqyrton rastet e shkeljeve te kontstatuara nga nepunesit dhe punonjesit e tjere te administrates tatimore qendrore dhe miraton masat disiplinore ne cilesine e "eprorit direkt".

2) Fillimi procedurave disiplinore pas:

a. kerkeses me shkrim te bere nga eprore e nepunesit apo punonjesit te administrates tatimore;
b. kerkeses me shkrim te bere nga tatimpaguesi ose
c. me iniciative te drejtorit te përgjithshem.

3) Masat disiplinore qe zbatohen per nepunesit civil te administrates tatimore jane në përputhje me legjislacionin për shërbimin civil.

## KREU III
## DISPOZITA ADMINISTRATIVE TE PERGJITHSHME

### Neni 23
### Menyrat e komunikimit me tatimpaguesin

1) Administrata tatimore mund te kerkoje perdorimin nga tatimpaguesit te formulareve te veçante per dorezimin ne administraten tatimore te dokumentacionit, informacionit apo kerkesave. Kur nuk kerkohet formular, çdo komunikim i kerkuar sipas legjislacionit tatimor dergohet ne menyre elektronike ose dorezohet me shkrim, me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe.

2) Vlerësimet, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare drejtuar tatimpaguesit i dergohen në adresën e shënuar në dosjen e tatimpaguesit duke përdorur shërbimin postar rekomande.

3) Si afati i marrjes dijeni per aktet dhe korrespondencen tjeter, që i dërgohet tatimpaguesit, do të konsiderohet të jetë shtatë ditë kalendarike pas datës së dergimit. Date e dergimit do te konsiderohet data e pranimit te dokumentit nga ana e sherbimit postar.

4) Tatimpaguesi eshte i detyruar te deklaroje adresen e sakte ne menyre qe te siguroje marrjen ne kohe te njoftimeve nga sherbimi postar.

5) Ministri i financave ne zbatim te ketij neni, me propozim te drejtorit te pergjithshem miraton llojet e dokumentacionit, te dhenat qe

duhet te perfshihen ne informacion si dhe procedurat dergimit prane administrates tatimore.

## Neni 24
## Dhenia e informacionit tatimor nga administrata tatimore

1) Informacioni tatimor ne lidhje me tatimpaguesin i administruar nga administrata tatimore, pas depozitimit te kerkeses, i ofrohet pa pagese autoriteteve te percaktuara ne kete nen, kur verifikohen rrethanat e meposhtme:

a. gjyqtarit, nese eshte ne gjykim ose ne hetim te nje çështje civile te lidhur me nje tatimpagues per pjesen qe i takon marrdhenieve te tij me administraten tatimore;
b. gjyqtarit ose prokurorit, nese eshte ne gjykim ose ne hetim te nje çeshtje penale te lidhur me nje tatimpagues per pjesen qe i takon marrdhenieve te tij me administraten tatimore;
c. kontrollit të lartë të shtetit, vetem per rastet kur kerkesa e bere eshte ne funksion te kontrollit te kryer nga ky institucion ndaj administrates tatimore ne funksion te hartimit te rekomandimeve te veta;
d. autoritetit te ngjashem te huaj me te cilin Kuvendi ka ratifikuar marreveshje nderkombetare dhe informacioni kerkohet ne kuader te ekzekutimit te marrveshjes;
e. autoritetit homolog te huaj ose autoriteteve vendase, me te cilat DPT ka nenshkrua marreveshje bashkepunimi dy ose shumepaleshe me objekt shkembimin e informacionit; si dhe
f. çdo autoriteti tjeter sipas parashikimit te bere me ligj te veçante.

## Neni 25
## Konfidencialiteti

1) Nepunesit dhe punonjesit e administratës tatimore qendrore dhe lokale, ruajnë konfidencialitetin e te dhenave tatimore dhe financiare të tatimpaguesve, që ata e kanë siguruar gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Ky paragraf nuk zbatohet per detyrimet tatimore per te cilat kane filluar procedurat e mbledhjes me force.

2) Detyrimi per ruajtjen e konfidencialitetit vazhdon edhe pasi nepunesi apo punonjësi nuk është më i punësuar pranë administratës tatimore.

3) Informacioni i lidhur me tatimpaguesin, perdoret brenda administrates tatimore, vetem ne masen e kerkuar per administrimin e tatimeve.

4) Kushti i ruajtjes se konfidencialitetit perfundon ne rastet kur tatimpaguesi heq dorë me shkrim nga e drejta e tij për ruajtjen e konfidencialitetit dhe per aq sa eshte lejuar ne deklarimin e bere nga tatimpaguesi.

5) Shkembimi i informacionit, i bere ne ekzekutim te marrveshjeve te lidhura nga administrata tatimore, behet me kushtin e ruajtjes se konfidencialitetit per institucionet dhe individet qe marrin dijeni per te dhenat tatimore.

**Neni 26**
**Shmangia e konfliktit te interesit**

1) Nepunesit e punonjësit e administratës tatimore, zbatojne në mënyrë të drejtë e të paanshme ligjet tatimore dhe nuk administrojne, ndikojne apo orientojne tatimpaguesin ne veprimtarine e tij, si dhe te deklarojne paraprakisht rastet kur kanë lidhje të drejtpërdrejtë ose jo te drejtperdrejte me tatimpaguesin.

2) Me perjashtim te rasteve te vet-vleresimit, nepunesit e administrates tatimore, nuk mund te kontrollojne apo vleresojne tatimet e veta apo te personave te lidhur.

3) Nepunesit e administrates tatimore nuk mund te punesohen ne kohe te pjesshme apo te plote ne veprimtari te ndryshme nga punesimi i tyre prane administrates tatimore, me perjashtim te veprimtarse se mesimdhenies.

**Neni 27**
**Publikimi i informacionit tatimor**

1) Administrata tatimore mund të publikojë informacionin e mbledhur nga veprimtaria e saj, me qellim përdorimin e te dhenave tatimore në hartimin e statistikave.

2) Publikimi behet në menyre dhe formë që nuk identifikon tatimpaguesit specifikë.

**Neni 28**
**Informimi i publikut**

1) Administrata tatimore ka për detyrë, qe duke përdorur te gjitha mjetet e komunikimit, perfshire median e shkruar dhe ate elektronike, t'i shpjegojë dhe informoje publikun ne lidhje me përmbajtjen, rolin dhe rëndësinë e legjislacionit tatimor. Drejtoria e pergjithshme e tatimeve publikon materiale sqaruese, komentarë dhe materiale te tjera shpjeguese ne lidhje me legislacionin tatimor.

2) Per qellime te informimit te publikut, për ligjet e reja tatimore, ndryshimet e bëra për legjislacionin tatimor dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, behet publikimi i akteve nëpërmjet medias se shkruar dhe elektronike, si dhe faqes zyrtare së internetit të drejtorisë së përgjithshme të tatimeve, jo më vonë se 15 dite nga data e miratimit te tyre.

**Neni 29**
**Dosja detyrimeve tatimore**

1) Administrata tatimore krijon dhe perditeson dosjen e detyrimeve tatimore, ne te cilin regjistrohen të gjitha detyrimet e tatimpaguesit sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjobave dhe pagesat që i takojnë tatimpaguesit.

2) Forma, menyra dhe afati i ruajtjes se te dhenave se dosjes percaktohet me rregullore te miratuar nga drejtorit te pergjithshem.

3) Administrata tatimore, ve ne dispozicion dhe garanton ne rruge elektronike aksesin e tatimpaguesit ne dorsjen e tij. Ne rastet kur tatimpaguesi nuk mund te perdore rrugen elektronike te marjes se te dhenave, ne pergjigje te kerkeses me shkrim te tatimpaguesit, administrata tatimore ve ne dispozicion kopje te dokumenta te dosjes.

## KREU IV
## TE DREJTAT E TATIMPAGUESIT

### Neni 30
### E drejta për informim dhe asistencë

1) Çdo tatimpagues ka të drejtë qe pa shperblim me qellim kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit tatimor, të marre informacion dhe te asistohet nga administrata tatimore. Brenda struktures se administrates tatimore krijohen strukturat pergjegjese per sherbimin e tatimpaguesve.

2) Çdo tatimpagues ka të drejtën e trajtimit të paanshëm, profesional dhe etik nga ana e administratēs tatimore, lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me detyrimet tatimore.

### Neni 31
### E drejta për konfidencialitetin e të dhënave

1) Çdo tatimpagues ka të drejtën e konfidencialitetit për te dhenat e veta tatimore e financiare, të administruara nga administrata tatimore.

2) E dhene tatimore dhe financiare, eshte çdo informacion i cili, merret nga administrata tatimore gjate ushtrimit te funksioneve, tek tatimpaguesi ose palet e treta.

### Neni 32
### E drejta për njoftim

1) Çdo tatimpagues ka të drejtë të marre njoftim për çdo akt administrativ, veprim ose mosveprim i bere per qellim te mbledhjes se detyrimeve tatimore e qe prek pasurine e tatimpaguesit, me perjashtim te rasteve kur administrata tatimore vlereson se ekziston rreziku real, qe pas kesaj tatimpaguesi do te bente transferimin e pronësisë, para se të perfundonte vleresimi tatimor.

### Neni 33

**E drejta për kontrolle të arsyeshme**

1) Tatimpaguesi ka të drejtën qe t'i sigurohen kontrolle te arsyeshme, të cilat te kryhen në kohë të arsyeshme, në vendin e duhur dhe brenda afateve, sipas dispozitave te këtij ligj.

**Neni 34**
**E drejta për informim**

1) Ne rastin e nje mosmarrveshje te lidhur me vleresimin tatimor te bere nga administrata tatimore, tatimpaguesi ka të drejtën te marre pergjigje me shkrim, ne lidhje me arsyet e vlerësimit si dhe të vendimit te marrë.

2) Në bazë të kërkesës me shkrim të tatimpaguesit, administrata tatimore lëshon vertetim ne lidhje me të ardhurat e tatueshme, të detyrimeve tatimore të mbetura si dhe pagesat e kryera nga tatimpaguesi.

**Neni 35**
**E drejta për përfaqësim**

1) Tatimpaguesi ka të drejtën të emërojnë një përfaqësues me prokure, i cili e perfaqeson ate ne raport me administraten tatimore.

2) Edhe ne rastin e emrimit te perfaqesuesit me prokure, tatimpaguesi mbetet personalisht përgjegjës në përmbushjen e detyrimeve të tij tatimore.

**Neni 36**
**E drejta për te kërkuar evidenca me shkrim apo ne rruge elektronike**

1) Tatimpaguesi ka te drejte te kerkoje nga administrata tatimore ne rruge elektronike apo me shkrim, kopje te njesuara me origjinalin, per çdo dokument qe ndodhet ne dosjen e hapur per tatimpaguesin apo te kerkoje kopje te printuar dhe te çertifikuar te te dhenave elektronike te lidhura me tatimpaguesin.

**Neni 37**
**E drejta për t'u dëgjuar**

1) Perpara marrjes se nje vendimi administrativ te lidhur me tatimpaguesit dhe pasurine e tij, tatimpaguesi ka të drejtë të dëgjohet nga administrata tatimore.

**Neni 38**
**E drejta për t'u ankimuar**

1) Tatimpaguesi gëzon të drejtën qe te ankohet dhe t'i sigurohet shqyrtimi pavarur administrativ i ceshtjeve te lidhura me të.

## KREU V
## DETYRIMI I TATIMPAGUESIT PER RREGJISTRIM

### Neni 39
### Regjstri i individeve

1) Si numer identifikimi per qellime tatimore, per tatimpaguesin qe eshte individ shërben numri personal i identifikimit i marre ne perputhje me legjislacionin e fushes.

2) Administrata tatimore qendrore mban rregister te veçante te individeve.

### Neni 40
### Regjistrimi i personave që ushtrojnë veprimtari tregtare

1) Personat fizikë dhe juridikë ushtrojne veprimtarinë ekonomiko tregtare vetëm pas regjistrimit të tyre në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

2) Personat e regjistruar sipas këtij ligji pajisen me numër identifikimi unik, të gjeneruar elektronikisht, i cili shërben si numri i identifikimit tatimor të tyre për tatimet kombëtare dhe vendore.

3) Afati për dorëzimin e aplikimit, formati i aplikimit dhe metoda e dorëzimit të aplikimit përcaktohen në ligjin "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Dokumentet e kërkuara si pjesë e aplikimit per qellime tatimore, përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

4) Regjistrimi në përputhje me ligjin "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" shërben njëkohësisht si regjistrim me skemat e sigurimit shoqëror dhe shëndetësor, inspektoratin e punës dhe organet doganore.

5) Mosregjistrimi nuk e çliron një person nga pagesa e detyrimit tatimor ose përmbushja e detyrimeve të tjera tatimore.

### Neni 41
### Identifikimi i personave që ushtrojne veprimtari tregtare pa u regjistruar

1) Kur administrata tatimore identifikon persona të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomiko tregtare pa u regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, i regjistron menjehere ata në një regjistër të përkohshëm.

2) Këta persona detyrohen që brenda 15 ditëve nga identifikimi i tyre nga administrata tatimore, te regjistrohen ne qender kombetare te regjstrimit. Nëse personi nuk regjistrohet brenda afatit të parashikuar nga ky paragraf, atij i mbyllet veprimtaria dhe nuk mund të regjistroje veprimtari tjeter për një periudhe prej gjashte muajsh.

3) Deri sa të përfundojë regjistrimi i tyre ne qendren kombetare te rregjistrimit, administrata tatimore, perllogarit dhe mbledh detyrimin tatimor si dhe gjobat administrative ne perputhje me këte ligj.

4) Administrata tatimore llogarit, vlerëson dhe mbledh detyrimet tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor gjatë periudhës deri në përfundimin e procesit të regjistrimit nga personi.

### Neni 42
### Regjistrimi i organizatave jofitimprurëse

1) Organizatat jofitimprurëse regjistrohen në administratën tatimore pasi kanë kryer më parë regjistrimin në përputhje me legjislacionin e fushes.

2) Administrata tatimore mban një regjistër elektronik të veçantë për organizatat jofitimprurese.

3) Në regjistrin e organizatave jo-fitimprurëse regjistrohen këto të dhëna:

a) emri;
b) kohëzgjatje, nësë kjo është e përcaktuar;
c) objektin e veprimtarisë;
d) vendin e ushtrimit të veprimtarisë;
e) të dhënat personale të drejtusit dhe të përfaqësuesit ligjor të organizatës;
f) dokumentin që vërteton kompetencat e përfaqësimit dhe afatet e emërimeve të tyre;
g) specimenë të përfaqësuesve të organizatës në raport me të tretët; dhe
h) numrin e të punësuarve.

4) Rregjistrimi ne administraten tatimore te organizatave jo-fitimprurese bëhet pas depozitimit në administraten tatimore të formularit të kërkesës së bashku me dokumentacionin bashkelidhur të parashikuar në formular. Formulari i kërkesës dhe dokumentacioni i kërkuar si pjesë e kerkeses publikuar në faqen zyrtare të drejtorise se pergjithshem të tatimeve mund të merret pa pagesë në çdo sportel te njesive te shërbimit ndaj tatimpaguesit.

5) Administrata tatimore brenda 5 diteve nga marrja e formularit të plotë dhe të saktë të aplikimit, përpunon kerkesen për regjistrim tatimor dhe e pajis kerkuesin me numër identifikimi.

6) Mosrespektimi i detyrimit per regjistrim, nuk e çliron organizaten jo-fitimprurese nga pagesa e detyrimeve tatimore.

### Neni 43
### Përditësimi i të dhënave të regjistrimit

1) Tatimpaguesi, person fizik dhe person juridik, regjistron cdo ndryshim të të dhënave në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, siç përcaktohet në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

2) Tatimpaguesi, statusi i të cilit ndryshon nga një kategori ne tjetrën sipas parashikimeve ne ligjet e veçanta tatimore, duhet të njoftojë administratën tatimore përkatëse, brenda 15 ditëve kalendarike nga data e rregjistrimit te ndryshimit. Kur një ndryshim i tillë i statusit diktohet nga një kontroll i kryer nga administrata tatimore qendrore

ose vendore, administrata që kryen kontrollin duhet të njoftojë administratën tjetër brenda 10 ditëve kalendarike pas këtij ndryshimi.

3) Organizatat jofitimprurëse duhet të njoftojnë administratën tatimore për ndryshimet që vijojnë brenda 15 ditëve nga data e rregjistrimit së ndryshimeve që vijojnë:

a) ndryshimi i emrit;
b) ndryshimi i adresës së veprimtarisë ose kontaktit;
c) ndryshimi i statusit ligjor;
d) krijimi/mbyllja e degëve, sektorëve ose njësive të reja;
e) ndryshimi i llojit të veprimtarisë ekonomike;
f) ndryshimi i numrit të punonjësve; dhe
g) çdo ndryshim tjetër të parashikuar në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

**Neni 44**
**Kalimi në regjistrin pasiv**

1) Administrata tatimore, kur zotëron prova se tatimpaguesi për një periudhë tatimore për 12 muaj të njëpasnjëshëm :

a. nuk ushtron më veprimtari tregtare;
b. nuk dorëzon deklaratën tatimore ose
c. deklaron pezullim veprimtarie tregtare,

transferon regjistrimin e një tatimpaguesi nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv që mbahet nga administrata tatimore.

2) Ne rastin e shkronjes c. te paragrafit te pare te ketij neni, per trensferimin kerkohet miratimi me shkrim i tatimpaguesit. Ne kete rast per te gjithe periudhen e qendrimit ne rregjistrin pasiv, nuk llogariten gjoba per mosdeklarim tatimor.

3) Administrata tatimore, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e transferimit të regjistrimit në regjistrin pasiv, njofton tatimpaguesin me shkrim.

4) Transferimi i regjistrimit tatimor nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv nuk eliminon detyrimin tatimor ekzistues, dhe nuk e ndalon administratën tatimore për vlerësimin ose mbledhjen e detyrimit tatimor pasi regjistrimi transferohet në regjistrin pasiv.

5) Administrata tatimore automatikisht transferon regjistrimin nga regjistri pasiv në regjistrin aktiv kur tatimpaguesi rifillon veprimtarinë, dorëzon gjithë deklaratat tatimore dhe bën gjithë pagesat e kërkuara.

**Neni 45**
**Çregjistrimi tatimor**

1) Personat e regjistruar në organin tatimor mund të çrregjistrohen në rastet që vijojnë:

a) për personat fizikë dhe juridikë sipas dispozitave të ligjit "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
b) për organizatat jofitimprurëse në bazë të vendimit të gjykatës.

2) Subjektet e regjistruara pranë Qendrës Kombëtare te Regjistrimit ose gjykatës çregjistrohen pasi të kenë paguar të gjithë

detyrimet tatimore të papaguara dhe pasi të kenë paraqitur bilancin e mbylljes për subjektet për të cilat paraqitja e këtij bilanci kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

3) Qendra Kombëtare e Regjistrimit ose gjykata njofton organin tatimor kompetent për regjistrimin e hapjes se procedurave të likuidimit apo për kërkesën për çregjistrim të personit fizik. Organi tatimor kompetent, brenda 30 ditësh nga data e këtij njoftimi është i detyruar të verifikojë situatën tatimore dhe, kur është e nevojshme të ushtrojë kontrollin në vend të veprimtarisë së subjektit.

4) Qendra Kombëtare e Regjistrimit ose gjykata nuk mund të kryejë çregjistrimin nëqoftëse brenda 30 ditëve, administrata tatimore e kundërshton çregjistrimin me shkrim. Kundërshtimi i çregjistrimit të tatimpaguesit nga administrata tatimore tregon shumën e detyrimeve tatimore të papaguara të tatimpaguesit.

5) Nëse pas 30 ditësh nga data e njoftimit, organi tatimor kompetent nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim me shkrim, apo kundërshtimi nuk përmban shumën e detyrimeve tatimore, gjobave dhe interesave te papaguara, Qendra Kombëtare e Regjistrimit ose gjykata kryen menjëherë çregjistrimin e subjektit.

6) Pasi subjekti ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore, gjobat dhe interesat e papaguara deri në datën e hapjes se procedurave te likuidimit apo te kërkesës për çregjistrim, organi tatimor kompetent detyrohet te tërheqë menjëherë kundërshtimin për çregjistrim dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit kryen menjëherë çregjistrimin e subjektit.

7) Nëse, brenda 30 ditëve, tatimpaguesi shlyen detyrimin e tij tatimor administrata tatimore e tërheq kundërshtimin menjëherë dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit e çregjistron tatimpaguesin brenda 5 ditëve kalendarike pas marrjes së njoftimit të tërheqjes së kundërshtimit nga administrata tatimore, ose pasi tatimpaguesi paraqet një dokument që vërteton pagesën e gjithë detyrimeve të tij tatimore.

8) Nëse pavarësisht shlyerjes, organi tatimor kompetent nuk ka tërhequr kundërshtimin, atëherë subjekti mund t'i paraqesë Qendrës Kombëtare te Regjistrimit dokumentin qe vërteton shlyerjen e shumës totale te detyrimeve tatimore, gjobave dhe interesave te përcaktuara ne kundërshtimin për çregjistrim. Ne këtë rast, Qendra Kombëtare e Regjistrimit kryen menjëherë çregjistrimin e subjektit dhe njofton organit tatimor kompetent.

9) Çregjistrimi tatimor nuk eliminon detyrimet ekzistuese tatimore dhe nuk parandalon administratën tatimore nga vlerësimi ose mbledhja e detyrimeve tatimore pas revokimit të regjistrimit.

## KREU VI
## MBAJTJA E TE DHENAVE

### Seksioni I
### Detyrimi per dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për qellime tatimore

## Neni 46
## Dokumentimi dhe mbajtja e të dhënave tatimore per tatimpaguesit qe jane subjekt i tvsh-se ose tatim-fitimit

1) Tatimpaguesit që janë subjekt i TVSH-së ose tatimit të fitimit, me qellim perllogaritjen e detyrimit tatimor, mbajnë regjistrat, dokumentacioni kontabel, librat dhe informacionin financiar si dhe lëshojnë faturë tatimore, dëftesë tatimore ose kupon tatimor në përputhje me ligjet e fushes si dhe aktet nenligjore te nxjerra ne zbatim te tyre.

2) Tatimpaguesit subjekt i TVSH-së regjistrojnë menjëherë gjithë veprimet financiare dhe përgatisin dhe mbajnë libra dhe regjistra kontabël ne te cilet regjistrohen:

a. shitjet e përditshme të mallrave ose kryerja e punimeve ose shërbimeve të tatueshme, duke përfshirë shumën e secilit veprim dhe shumën e tatimit të ngarkuar;
b. veprimet e përfunduara por akoma të pafaturuara;
c. veprimet e patatueshme;

si dhe

d. pagesat për mallra dhe shërbime, përfshi shumën e secilës blerje ose pagesë, shumën e tatimit të paguar, dhe emrin dhe adresën e furnizuesit.

## Neni 47
## Dokumentimi dhe mbajtja e të dhënave tatimore per tatimpaguesit e klasifikuar si biznes i vogel

1) Tatimpaguesit që janë subjekt i Ligjit "Për Taksën Vendore të Biznesit të Vogël", me qellim te perllogaritjes se detyrimit tatimor, mbajnë regjistra, libra dhe dokumente të tjera si dhe lëshojnë fature te thjeshte tatimore apo kupona tatimorë, ne perputhje me dispozitat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore" si dhe dispozitat e ligjit "Per tatimin mbi te ardhurat".

## Neni 48
## Mbajtja dhe ruajtja e dokumentave te te dhenave tatimore

1) Regjistrat, librat dhe informacioni financiar jane dokumenta te cilat permbajne informacionin e regjistruar ne menyre kronologjike dhe sistematike te veprimeve tregtare të tatimpaguesit, dhe te cilat mbahen me qëllim të përcaktimit te shumes e detyrimeve tatimore të këtij tatimpaguesi.

2) Të dhënat dhe informacioni financiar dhe kontabël ruhen nga tatimpaguesi për te pakten gjashte vjet duke filluar nga fundi i vitit tatimor të cilit i përkasin dokumentet.

3) Tatimpaguesi per çdo shitje leshon fature tatimore ose kupon tatimor.

## Neni 49

**Fatura tatimore**

1) Çdo shit-blerje mallrash apo te drejtash si dhe çdo kryerje punimi apo shërbimi që eshte pjese e veprimtarise tregtare është objekt faturimi.

2) Faturat për shitjen e sendeve a kryerjen e punimeve e të shërbimeve janë fatura tatimore, të cilat perfshihen ne perllogaritjet e detyrimit tatimor.

3) Fatura tatimore përmban numrin rendor dhe numrin personal te identifikimit, numrin e identifikimit te tatimpaguesit, datën dhe vendin e lëshimit, emrin dhe adresën e palëve, datën e realizimit të shitjes ose të punimit a shërbimit, emërtimin e saktë të tyre, çmimin e plotë të shitjes dhe nëse është rasti, rritjet ose zbritjet e tjera të zbatuara, si dhe shumat e shifruara, cilado qoftë mënyra e likujdimit të faturës.

**Neni 50**
**Fatura tatimore me tvsh**

1) Tatimpaguesi qe i nenshtrohet tatimit mbi vleren e shtuar, sa here qe ofron mallra apo sherbime per nje person tjeter, duhet te leshoje fature tatimore me tvsh.

2) Ministri i financave me udhezim mund te parashikoje transaksione per te cilat nuk ekziston detyrimi i leshimit te nje fature tatimore duke percaktuar kriteret per dokumentimin e ketyre transaksioneve.

3) Përveç përshkrimeve dhe të dhënave të parashikuara në paragrafin e trete të nenit me siper, fatura tatimore me tvsh përmban :

a. vlerën mbi të cilin përllogaritet tvsh-ja;
b. vleren me tvsh te zbatuar sipas kategorive te sendeve, punimeve e sherbimeve
c. shumën e tvsh-se.

4) Ministri i Financave me udhezim, mund të përcaktojë kërkesa të tjera që duhet të përmbajë një faturë tatimore për rastet që rrjedhin nga veçoritë e veprimtarive te zhvilluara, të sendeve te tregtueshme, te punimeve apo te shërbimeve.

**Neni 51**
**Lëshimi i faturës tatimore**

1) Shitësi lëshon faturë tatimore dhe blerësi duhet të kërkojë atë në kohën e realizimit të shitjes a të kryerjes së punimit ose shërbimit. Fatura tatimore përgatitet nga shitësi në jo më pak se dy ekzemplarë, nga të cilët njëren kopje e merr dhe ruan blerësi, kurse kopjen e mban dhe e ruan shitësi. Faturat përgatiten me numër rendor progresiv.

2) Tatimpaguesi qe mban ne ruajte, përdor apo transporton mallra te pashoqeruar me dokumenta tatimore, denohet ne perputhje me nenin 121 te ketij ligji.

3) Ministri i Financave, per efekt te llogaritjes se vleres se gjobes, ne perputhje me shkronje b) te paragrafit te pare te nenit 121 te ketij

ligji, percakton me udhezim, menyren e perllogaritjes se vleres se tregut, per mallrat qe gjenden ne qarkullim te pashoqeruara me fature tatimore.

**Neni 52**
**Prodhimi dhe shperndarja**
**e dokumentave tatimore**

1) Ministri i financave miraton formatin e fatures tatimore, e cila shtypet dhe shperndahet nga autoritetet tatimore apo nga subjekte private te autorizuara.

2) Kriteret qe duhet te plotesojne personat qe liçencohen per shtypjen dhe shperndarjen e dokumentacionit tatimore, kushtet e shtypjes, informacionin qe duhet te permbajne, standartet e sigurise si dhe rregullat e shperndarjes dhe venies ne dispozicion të tatimpaguesve te faturave tatimore, miratohen me vendim te keshillit te ministrave.

3) Ne rastet kur sherbimi i shtypjes dhe shperndarjes se dokumentave tatimore, do te behet nga subjekte tregtare private, autorizimi per shtypjen dhe shperndarjen e dokumentave tatimore, leshohen nga drejtori i pergjithshem i tatimeve.

**Neni 53**
**Faturat tatimore**
**te përgatitura nga blerësi**

1) Në rastin e shitjeve nga individët që nuk kanë cilësinë e tregtarit, fatura përgatitet nga blerësi, ushtrues i veprimtarisë tregtare, me kusht që dokumenti të përmbajë përshkrimet dhe të dhënat e parashikuara në kete ligji dhe vërtetohet nga furnizuesi. Blerësi për çdo rast të tillë shënon në faturë edhe numrin e tij te identifikimit.

2) Ministri i Financave me udhezim mund të parashikoje forma të posaçme dokumentesh që zënë vendin e faturës.

**Neni 54**
**Kuponi tatimor**

1) Kuponi tatimor eshte dokumenti i lëshuar me anë të pajisjeve fiskale a të pajisjeve elektronike të tjera që kanë aparat shtypshkrimi.

2) Subjektet që detyrohen të lëshojnë kupona tatimorë, mund të lëshojnë njëherazi edhe faturë, nëse shitja apo shërbimi i kryer është për një përdorim tregtar dhe për këtë shkak blerësi është i detyruar ta kërkojë faturën.

3) Te gjithe tatimpaguesit e shitjeve me pakice qe shesin mallra apo ofrojne sherbime ne ambjente apo njesi te perhershme te hapura per publikun, duhet te instatojne pajisje fiskale dhe te leshojne kupona tatimor per cdo transaksion.

4) Kuponi tatimor i pashoqëruar me faturë, nuk njihet si dokument justifikues i shpenzimeve për blerësin, ushtrues të një veprimtarie tregtare.

**Seksioni II**
**Pajisjet fiskale**

**Neni 55**
**Detyrimi per perdorimin e pajisjeve fiskale**

1) Tatimpaguesit që kryejnë qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, janë të detyruara të fusin dhe të përdorin sistemin fiskal nepermjet perdorimit te paisjeve fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe leshimit në mënyrë të detyrueshme te kuponit tatimor.

2) Keshilli i Ministrave miraton karakteristikat teknike funksionale te pajisjeve fiskale, sistemit te integruar te kompjuterizuar per trensferimet periodike, automatike te deklarimeve financiare, sistemit te komunikimit, proceduren dhe dokumentacionin per miratimin e tyre, per kriteret per pajisjen me autorizim te shoqerive qe ofrojne pajisjet fiskale si dhe kushtet e heqjes se autorizimit per keto shoqeri.

3) Ministri i Financave me udhezim miraton procedurën dhe dokumentacionin për miratimin për përdorim te pajisjeve fiskale, elementët e kuponit tatimor, mënyrën e kontrollit dhe kontrollin e paisjes fiskale, distancen e ruajtjes se kuponit tatimor, dhe rregullat për mirëmbajtjen e tyre teknike dhe të shërbimit.

**Neni 56**
**Kontrolli i sistemit automatik mbledhjes se te dhenave te pajisjeve fiskale**

1) Ministri i Financave, mund te vendose qe mbledhja e te dhenave te pajisjeve fiskale te behet nepermjet nje sistemi automatik.

2) Sherbimi sistemit te kontrollit automatik mund te kryhet nga subjektet e pajisura me autorizim nga drejtori i pergjithshem i tatimeve, mbi bazen e kritereve te parashikuar me vendim te keshillit te ministrave.

**Seksioni III**
**Mbajtja e kontabilitetit per qellime tatimore**

**Neni 57**
**Dokumentimi dhe mbajtja e llogarive për qëllime tatimore**

1) Tatimpaguesi mban kontabilitetin në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" si dhe akteve te miratuara ne mbeshtetje te tij.

2) Për regjistrimin e veprimeve ekonomike që lidhen me tatimet dhe taksat përdoren edhe librat, regjistrat apo dokumentacioni i përcaktuar në ligjet tatimore specifike dhe në dispozitat përkatëse nënligjore.

3) Tatimpaguesit janë të detyruar të përdorin dokumentacionin bazë, përfshirë faturën tatimore, në përputhje me legjislacionin tatimor dhe dispozitat nënligjore përkatëse.

4) Tatimpaguesit që janë subjekt i ligjit nr. 9632, date 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", me qëllim të përllogaritjes se detyrimit tatimor, mbajnë regjistra, libra dhe dokumente të tjera si dhe lëshojnë fatura të thjeshta tatimore, dëftesa tatimore dhe kupona tatimorë ne perputhje me ligjin e fushes si dhe aktet nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij. Gjithashtu këta tatimpagues mbajnë dokumentacion tatimor sipas kërkesave që ly ligj apo ligjet specifike tatimore dhe dispozitat përkatëse nënligjore në zbatim të tyre përcaktojnë për këta tatimpagues.

5) Të dhënat dhe regjistrat e nevojshëm lidhur me tatimet mund të mbahen në formë elektronike, kur legjislacioni tatimor apo dispozitat përkatëse nënligjore nuk e pengojnë një gjë të tillë, me kusht që të garantojnë në çdo kohë evidence të plotë të veprimeve ekonomike dhe të dhënave lidhur me tatimet.

## Seksioni IV
## Detyrime te tjera te tatimpaguesit dhe te treteve

### Neni 58
### Dokumentat tatimore te transportit

1) Tatimpaguesit që mbajnë, tregtojnë, përdorin ose transportojnë mallra duhet të përftojnë dokumentet e nevojshme tatimore që provojnë pronësinë ose kontrollin mbi këto mallra dhe, me kërkesën e zyrtarëve të administratës tatimore, i vënë këto dokumente në dispozicion të tyre.

### Neni 59
### Pagesat me para ne dore

2) Tatimpaguesit persona fizike apo juridike tregtarë, nuk mund të kryejnë midis tyre transaksione shitje ose blerje me para në dorë, kur vlera e transaksionit është më e madhe se 300.000 lekë.

3) Perveç detyrimeve te tjera te parashikuara ne kete ligj, tatimpaguesi ne perputhje me legjislacionin tatimor duhet te reklamojne ne vende te dukshme, çmimet e mallrave dhe te sherbimeve qe ofrojne si dhe ne rastet kur ushtron njekohesisht tregti me shumice dhe me pakice, eshte i detyruar qe t'i organizoje keto veprimtari ne vende te veçanta te ndara nga njeri tjetri.

### Neni 60
### Detyrimi i tatimpaguesit për të dhënë informacion dhe lejuar hyrjen

1) Tatimpaguesi vë në dispozicion të administratës tatimore librat, rregjistrimet, informacionin, dokumentet e nevojshme për të kryer llogaritjen e saktë të detyrimeve të tyre tatimore.

2) Tatimpaguesi lejon hyrjen e nepunesve te administrates tatimore ne mjediset e veprimtarise se tij ekonomike gjate orarit zyrtar te punes.

3) Me kerkesen e administrates tatimore, tatimpaguesi., jep sqarime shtese, me gojë ose me shkrim. Ky detyrim përfshin, por nuk kufizohet në:

a. plotësimin, nënshkrimin dhe kthimin e pyetësorëve ose kërkesave të tjera me shkrim për informacione ose dokumente nga administrata tatimore brenda 20 ditëve nga data e postimit të kërkesës ose dërgimit elektronik tek tatimaguesit;
b. takimin me punonjës të administratës tatimore gjatë orarit të punës për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe dhënë informacion sipas nenit 94 te ketij ligji.

4) Kërkesa e administratës tatimore për sqarime shtese, behet vetem per informacione te lidhura me transaksionet tregtare të tatimpaguesit, proceset ose procedurat teknike, dhe operacione financiare ndërmjet tatimpaguesit dhe palëve të treta.

**Neni 61**
**Detyrimi i të treteve**
**për të dhënë informacion**

1) Me kërkesën e administratës tatimore, palët e treta japin informacion me shkrim ose me gojë, vënë në dispozicion librat dhe regjistrimet si edhe informacion tjetër lidhur me detyrimin tatimor të një tatimpaguesi me të cilin ata kanë hyrë në transaksione tregtare ose financiare. Ky detyrim përfshin, por nuk kufizohet në:

a) plotësimin, nënshkrimin dhe kthimin e pyetësorëve me shkrim, ose kërkesave të tjera me shkrim për informacion ose dokumente, nga administrata tatimore brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur kërkesa, dërguar me postë ose në mënyrë elektronike, është marre ose konsiderohet të jetë marrë prej palës së tretë;
b) takim me punonjësit e administratës tatimore gjatë orarit zyrtar të punës në mjediset e veprimtarisë ekonomike të palës së tretë ose në zyrat e administratës tatimore për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për të dhënë informacion në bazë të fletëthirrjejes me shkrim sipas nenit 94 të këtij ligji.

2) Kur tatimpaguesi ose një palë e tretë nuk përmbush detyrimet e parashikuara sipas këtij kreu, administrata tatimore mund të ushtroje autoritetin e saj ne përputhje me dispozitat e këtij ligji.

**Neni 62**
**Personat te cileve ju adresohet**
**kerkesa per te dhene informacion**

1) Kerkesa me shkrim behet per te dhenat e nevojshme per te perllogaritur detyrimin tatimor dhe ju drejtohet:

a. personave juridikë, në lidhje me:

(1) dividentët që u paguhen aksionerëve ose ortakëve;
(2) personat me te cilet jane duke kryer ose kanë kryer transaksione financiare ose tregtare;
(3) pagesat e bëra per nën-kontraktorët apo ne pozicionin e nen-kontraktorit ose
(4) debitorët dhe kreditorët

b. bankave dhe institucioneve financiare, në lidhje me:
1- pagesat e interesit;
2- depozitat dhe detyrimet në fund të vitit;
3- veprime të tjera bankare ose
4- rregjistrin elektronik te llogarise bankare ne emer te tatimpaguesit perfshire emrin tregtar dhe numrin personal te identifikimit;

c. shoqeritve komisionere ose fondeve te investimeve kolektive, në lidhje me transaksionet e titujve;

d. agjentëve te pasurisë së paluajtshme, në lidhje me veprimet per klientë e tyre;

e. blerësve ose shitësve te pasurisë së paluajtshme, në lidhje me përshkrimin dhe çmimin e pasurisë së paluajtshme;

f. notereve, per veprime noteriale lidhur me shitblerje te pasurive te luajteshme apo te paluejteshme, apo kontrata sipermarrje;

g. personave juridikë rezidentë dhe jo-residentë në lidhje me pagesat e bëra personave jo-rezidentë;

h. institucioneve shteterore si dhe nepunesve te administrates shteterore;

i. kontraktoreve te tjere te tatimpaguesit

j. donatorëve, organizatave nderkombetare, organizatave jofitimprurese vendase dhe te huaja, në lidhje me pagesat e bëra tatimpaguesve për furnizimin e mallrave dhe të shërbimeve.

## Neni 63
## Perjashtimi nga detyrimi per te dhene informacion

1) Në rast të hetimit tatimor nga organet e prokurorisë, personat e mëposhtëm kanë të drejtë të refuzojnë dhënien e informacionit sipas këtij neni:

a) anëtarët e familjes së tatimpaguesit;
b) avokatët, noterët, këshilltarët tatimorë, doktorët, personeli mjekësor për informacionin me të cilin janë njohur në rrjedhën e zakonshme të veprimtarisë së tyre profesionale; dhe

2) Me përjashtim të tatimpaguesit, personat që janë të detyruar të japin informacion në përputhje me këtë nen nuk janë të detyruar të japin informacion që mund t’i ekspozojë ata, ose anëtarët e shkallës së parë të familjes së tyre, për ndjekje penale. Në këtë rast, administrata tatimore duhet ta njohë tatimpaguesin me të drejtën e tyre për të refuzuar dhënien e informacionit dhe ky informacion duhet të regjistrohet dhe nënshkruhet nga personi i interesuar.

## KREU VII

## DEKLARATA TATIMORE

### Neni 64
### Deklarata tatimore

1) Tatimpaguesi dorëzon deklaratë të plotë dhe të saktë tatimore në ose para dates së dorëzimit të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës.

2) Kur ligji tatimor kërkon dorëzimin e deklarates tatimore, tatimpaguesi bën vetdeklarim të shumes se detyrimit tatimor apo kontributit, pa pritur vlerësimin, njoftimin ose kërkesën nga administrata tatimore dhe paguan këtë tatim në afatin dhe vendin e përcaktuar në ligjin tatimor përkatës, pavarësisht nga shtyrja e afatit për dorëzimin e deklaratës tatimore.

3) Deklaratat dhe formularët e tjerë që duhen dorëzuar nga tatimpaguesi, vihen ne dispozicion te publikut pa pagese nepermjet:

1- publikimit në faqen zyrtare e internetit të administratës tatimore;

2- sporteleve e njesive te sherbimit per tatimpaguesin; ose

3- dërgimit me postë duke përdorur shërbimin postar rekomande per ata tatimpagues qe paraqesin kerkese me shkrim per ofrimin e ketij sherbimi.

4) Formatet e deklaratave si dhe dokumentacioni qe i bashkelidhet deklarates tatimore miratohen me udhezim te Ministrit te Financave.

### Neni 65
### Dorëzimi i deklarates tatimore

1) Tatimpaguesi dorëzon deklaraten tatimore nepermjet:

1- postës sipas dispozitave te ketij ligji;

2- në mënyrë elektronike ose

3- nepermjet bankes apo nje institucioni tjeter financiar.

2) Ministri i Financave me udhezim miraton proceduren e dorezimit te deklarates tatimore.

3) Në rastet kur, afati i fundit per dorëzimin e deklarates bie ne dite pushimi, atehere si dite e fundit e aftatit llogaritet dita e pare e punës e cila vjen më pas.

4) Tatimpaguesi dhe, nëse ka, përfaqësuesi i tij nënshkruajnë deklaratën tatimore, shënojnë numrat e tyre të identifikimit tatimor dhe konfirmojnë nën përgjegjësi e tyre që deklarata është e plotë dhe e saktë.

5) Deklarata tatimore konsiderohet e dorezuar nese plotesohen kerkesat e ketij ligji, legjislacionit tatimor dhe akteve nenligjore te dala ne zbatim te tyre

### Neni 66
### Zgjatja e afatit
### për dorëzimin e deklarates tatimore

1) Në rastet kur tatimpaguesi ndodhet perpara pamundesise per dorezimin ne kohe te deklarates tatimore, ai paguan detyrimin tatimor dhe njofton administraten tatimore per zgjatjes të afatit të dorëzimit të deklarates tatimore. Ne rastet e pamundesise per dorezimin ne kohe te deklarates tatimore, afati i dorezimit zgjatet automatikisht per 30 dite dhe per kete periudhe nuk zbatohet masa e gjobes.

2) Zgjatja e afatit për dorëzimin e deklaratës tatimore, nuk ndikon në afatin e pagesës së detyrimit tatimor dhe ne perllogaritjen e kamatë-vonesës për detyrimin tatimor i cili do te rezultoje si i papaguar ne momentin e dorezimit te deklarates tatimore.

**Neni 67**
**Deklarata tatimore e ndryshuar**

1) Tatimpaguesi mund të dorëzojë deklarate te re tatimore ne te cilen ka paraqitur ndryshme ne rastet kur ai konstaton se deklarata tatimore fillestare ishte e pasaktë dhe me mangësi.

2) Deklarata e ndryshuar mund dorëzohet brenda dymbedhejete muajve nga afati i dorëzimit të deklaratës fillestare.

3) Dorëzimi i një deklarate tatimore të ndryshuar përfshin:

a) pagesën e çdo detyrimi tatimor shtesë për t'u paguar;

b) kamatëvonesën për periudhën ndërmjet afatit të dorëzimit të deklaratës fillestare dhe datës së dorëzimit të deklaratës tatimore të ndryshuar;

c) kerkese nga tatimpaguesi per kreditimin e tatimit te paguar me teper plus interesat e llogaritura per kete periudhe, duke e llogaritur kete shume per llogari te detyrimeve tatimore te tjera ekzistuese apo te ardhshme ose

d) kerkese per rimbursimin e tatimit te paguar me teper plus interesat.

3) Per llogaritjen e interesit te permendur ne paragrafin e trete te ketij neni, zbatohen dispozitat e ketij ligji per kamatvonesen.

**KREU VIII**
**VLERESIMI TATIMOR**

**Neni 68**
**Vlerësimi tatimor**

1) Vlerësimi tatimor:

a) është llogaritja e detyrimit tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore; dhe

b) në rastet kur shuma e detyrimit tatimor te vetdeklaruar nuk paguhet, eshte njoftimi që kërkon pagesën e detyrimit tatimor në datën e caktuar në ligjin përkatës.

2) Nëse tatimpaguesit i kërkohet të dorëzojë deklaratë tatimore dhe të paguajë detyrimin tatimor, deklarata konsiderohet si vetvlerësim tatimor. Pagesa e tatimit bëhet në menyren dhe afatin e parashikuar në ligjin tatimor përkatës.

3) Nëse detyrimi tatimor mbahet në burim nga një agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, dhe tatimpaguesi nuk është subjekt i kërkesës së dorëzimit të deklaratës tatimore për tatimin e mbajtur në burim, mbajtja e tatimit në burim është vlerësim tatimor.

4) Nëse administrata tatimore konstaton se detyrimi tatimor i dhënë në deklaratën tatimore është i pasaktë ose tatimpaguesi nuk ka dorëzuar deklaratë tatimore ose kur tatimpaguesi nuk ka paguar detyrimin tatimor, administrata tatimore bën vlerësimin tatimor.

5) Administrata tatimore vlerëson detyrimin tatimor të tatimpaguesit në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës. Vlerësimi bazohet në:

a) informacionin që përmban deklarata tatimore e tatimpaguesit; ose
b) rezultatet e një kontrolli në përputhje me kreun IX të këtij ligji; ose
c) metodat alternative të vlerësimit të parashikuara në nenin 72 të këtij ligji.

5) Vlerësimi i bëre nga administrata tatimore hyn në fuqi 10 ditë kalendarike pas datës kur njoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesës për të paguar konsiderohet të jetë marrë, si parashikohet në nenin 69 të këtij ligji.

6) Kur një vlerësim bëhet në përputhje me paragrafin 5 shkronjat b) ose c) të këtij neni, barra e provës që shuma e këtij vlerësimi është e pasaktë bie mbi tatimpaguesin.

7) Shuma e detyrimit tatimor e deklaruar sipas deklaratës tatimore me vlere deri në 1 000 lekë, konsiderohet si detyrim me vlere zero dhe për shuma të tilla nuk bëhet vlerësim tatimor nga administrata tatimore.

**Neni 69**
**Njoftimi i vlerësimit tatimor**
**dhe kërkesa për pagesën e detyrimit tatimor**

1) Administrata tatimore, brenda 10 ditëve kalendarike nga llogaritja e vlerësimit prej saj, duhet t'i dërgojë me postë rekomande tatimpaguesit, njoftimin e vlerësimit dhe kërkesën për pagesën e detyrimit tatimor.

2) Njoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën e tatimit duhet të përmbajë informacionin që vijon:

a) emrin dhe mbiemrin e tatimpaguesit person fizik ose emrin e personit juridik;
b) numrin e identifikimit të tatimpaguesit;
c) datën e njoftimit;
d) çeshtjen për të cilën bëhet njoftimi dhe periudhën ose periudhat tatimore që u referohet njoftimi;
e) shumën e tatimit të vlerësuar, kamatëvonesën dhe gjobat;
f) kërkesën për pagesën e tatimit dhe afatin e pagesës;
g) vendin dhe mënyrën e pagesës së tatimit;
h) shpjegimin e arsyes së vlerësimit; dhe

i) shpjegimin e të drejtës së tatimpaguesit për të ankimuar vlerësimin.

3) Njoftim vlerësimi tatimor dhe kërkesa për pagesën e tij rregjistrohen nëdosjen e tatimpaguesit, brenda 5 ditëve kalendarike nga data e lëshimit.

4) Nëse tatimpaguesi nuk bie dakort me vlerësimin e detryimit tatimor të kryer nga administrata tatimore, tatimpaguesi, brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja ose marrja e konsideruar e njoftimit të vlerësimit dhe kërkeses, mund të ankimoje në përputhje me proçedurat e parashikuara në Kreun XIII të këtij ligji.

**Neni 70**
**E drejta për të nxjerrë**
**njoftim vlerësimi tatimor**

1) Drejtoria rajonale tatimore nxjerr njoftim vlerësimi tatimor për tatimpaguesit e regjistruar në administratën tatimore qendrore.

2) Për detyrimet tatimore të lidhura me kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore, njoftim-vleresimi tatimor në të gjitha rastet nxirret nga drejtori i drejtorise rajonale.

3) Zyra tatimore e qeverisjes vendore ka të drejtë të nxjerr njoftim vlerësimi tatimor për tatimpaguesit që klasifikohen si biznes i vogël.

**Neni 71**
**E drejta për të përdorur**
**metoda alternative të vlerësimit**

1) Administrata tatimore ka të drejtë të përdorë metoda alternative për vlerësimin e detyrimit tatimor të tatimpaguesit dhe të nxjerrë një vlerësim në rastet kur:

a) tatimpaguesi nuk dorëzon deklaratën tatimore në përputhje me afatin dhe metodën e kërkuar në legjislacionin tatimor përkatës;
b) deklarata tatimore përmban të dhëna të pasakta ose të fallsifikuara;
c) tatimpaguesi nuk mban ose ruan llogari ose regjistrime të sakta të transaksioneve të tij;
d) tatimpaguesi nuk bashkëpunon me kontrollin tatimor të autorizuar;
e) tatimpaguesi nuk vë në dispozicion informacionin e kërkuar dhe dokumente të tjera të nevojshme për llogaritjen e detyrimit të tij tatimor;
f) tatimpaguesi hyn në transaksione me persona të lidhur jo mbi bazën e parimit të vlerës së tregut, ose hyn në transaksione pa efekte ekonomike thelbësore; ose
g) tatimpaguesi hyn në transaksione shitblerjeje me para në dorë që tejkalojnë shumën 300 000 lekë;
h) tatimpaguesi nuk perdor rregullisht pajisjen fiskale.

## Neni 72
## Baza e metodave alternative të vlerësimit

1) Metodat alternative të vlerësimit nuk kufizohen por bazohen në:

a) të dhëna të drejtpërdrejta që gjenden në deklaratat tatimore ose dokumente a informacion tjetër dhënë nga tatimpaguesi;
b) të dhëna të drejtpërdrejta, dokumente ose informacion i dhënë nga palë të treta;
c) krahasime me një veprimtari ekonomike të ngjashme të kryer nga tatimpagues të tjerë; ose
d) të dhëna të tërthorta bazuar në çmimet e tregut të mallrave dhe shërbimeve të ngjashme si dhe te pagave krahasuese; ose
e) çmimet e referencës të shitjeve me pakicë kur tatimpaguesit e TVSH-së nuk lëshojnë ose nuk mbajnë fatura tatimore.

2) Kur vlerësohet detyrimi tatimor që lind nga transaksione ndërmjet personave të lidhur, metoda alternative e përdorur pasqyron të ardhurat e tatueshme që do të kishin rezultuar nga transaksione të krahasueshme ndërmjet personave të palidhur.

3) Rregullat per zbatimin e këtij neni përcaktohen ne udhëzimin e Ministrit te Financave të nxjerrë në zbatim të këtij ligji.

## Neni 73
## Afati i parashkrimit të së drejtës për të bërë vlerësim tatimor

1) E drejta e administratës tatimore për të bërë një vlerësim tatimor, parashkruhet brenda 6 vjetëve nga dita e fundit e dorëzimit të deklaratës tatimore të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës.

2) Afati i parashkrimit në paragrafin e pare mund të ndërpritet kur:

a) si rezultat i apelimit të vlerësimit të mëparshëm bëhet një vlerësim i ri. Në këtë rast afati i parashkrimit është më i mëvonshmi prej:
    i) afatit të parashkrimit të përcaktuar në paragrafin e pare të këtij neni; dhe
    ii) 30 ditëve kalendarike nga data e vendimit përfundimtar të apelit.
b) si rezultat i një kontrolli ose hetimi tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore bëhet një vlerësim i ri. Në këtë rast afati i parashkrimit është më i mëvonshmi prej:
    i) afatit të parashkrimit të përcaktuar në paragrafin e pare të këtij neni, dhe
    ii) 30 ditëve kalendarike nga data e nxjerrjes së vendimit përfundimtar me shkrim të kontrollit ose hetimit tatimor.
c) ndaj tatimpaguesit ka filluar një çështje penale lidhur me detyrimet e tij tatimore. Në këtë rast afati i parashkrimit është më i mëvonshmi prej:

i) afatit të parashkrimit të përcaktuar në paragrafin e pare të këtij neni, dhe
ii) 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes nga gjykata të vendimit të formës së prerë në lidhje me çështjen penale.

3) Ne rastet kur ndaj tatimpaguesit hapet nje çeshtje penale e lidhur me detyrimet e tij tatimore pas kalimit te afatit te parashikuara ne paragrafin e pare te ketij neni, e drejta per te bere vleresim tatimor konsiderohet se nuk eshte parashkruar.

## KREU IX
## PAGESA DHE RIMBURSIMI I TATIMIT

### Neni 74
### Afatet dhe metodat e pagesës së detyrimit tatimor

1) Tatimpaguesi shlyen detyrimet tatimore brenda afateve të parashikuara në ligjin tatimor përkatës.

2) Kur administrata tatimore nxjerr vlerësimin e një detyrimi tatimor në përputhje me Kreun III të këtij ligji, detyrimi tatimor i vlerësuar paguhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data në të cilën tatimpaguesi ka marrë ose konsiderohet të ketë marrë njoftimin e vleresimit dhe kërkesën për pagesë.

3) Tatimpaguesi mund t'i paguajë detyrimet tatimore në mënyrë elektronike, nëpërmjet bankave ose institucioneve të tjera që kane lidhur marrëveshje me administratën tatimore për të pranuar këto pagesa. .

4) Kur afati i fundit për pagesën e detyrimit tatimor, bie në ditë pushimi, datë e pagesës së tatimit është dita e parë e punës që vjen më pas.

5) Të gjitha pagesat tatimore kryhen në lekë.

### Neni 75
### Detyrimet tatimore të paguara më tepër

1) Kur shuma e detyrimit tatimor të paguar është më e madhe se shuma e tatimit të vlerësuar në njoftimin vlerësimin tatimor, administrata tatimore:

a) e kalon shumën e paguar më tepër për llogari të detyrimeve të tjera tatimore të papaguara të tatimpaguesit; dhe pas kësaj,
b) me pëlqimin me shkrim të tatimpaguesit, shuma e mbetur ose:
   i) rimbursohet automatikisht brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja e shumës së paguar më tepër; ose
   ii) në bazë të kërkesës me shkrim të tatimpatuesit, kalohet për llogari të detyrimeve tatimore të ardhshme të tatimpaguesit.

2) Veprimet lidhur me shumat e paguara më tepër për detyrimet tatimore, regjistrohen në dosjen e tatimpaguesit.

## Neni 76
## Kamatëvonesa

1) Kur detyrimi tatimor nuk paguhet në afat, tatimpaguesi është i detyruar që, për periudhën nga afati i pagesës deri në datën e pagesës së tatimit, të paguajë kamatëvonesë mbi këtë shumë në masen e përcaktuar në paragrafin e trete të këtij neni.

2) Nëse një rimbursim, i cili duhej kryer nga administrata tatimore sipas nenit 75 të këtij ligji, nuk kryhet brenda 30 ditëve kalendarike, administrata tatimore paguan kamatëvonesë mbi shumën e paguar më tepër si vijon:

a) kur një shumë e paguar më tepër kreditohet kundrejt një detyrimi tatimor tjetër, kamatëvonesa paguhet duke filluar nga data e pagesës më tepër deri në afatin e pagesës së tatimit kundrejt të cilit bëhet kreditimi;
b) kur një shumë e paguar më tepër rimbursohet, kamatëvonesa paguhet për periudhën nga 30 ditë pas bërjes së pagesës më tepër deri në kryerjen e rimbursimit.

3) Masa e kamatëvonesës sipas këtij neni është në masën 120 përqind të shkallës së interesit ndërbankar të Bankës së Shqipërisë, që përcaktohet çdo tremujor në bazë të shkallës mesatare të tremujorit paraardhës.

4) Kamatëvonesa paguhet në çdo rrethanë dhe nuk mund të hiqet nga administrata tatimore, as të ankimohet, me përjashtim të rasteve kur ka gabime në llogaritje ose kur detyrimi tatimor për të cilin aplikohet ndryshon.

## Neni 77
## Marreveshja e pagesës me këste

1) Kur një rrethanë financiare pengon tatimpaguesin për të paguar plotësisht dhe në afat detyrimet e tij tatimore, ai mund të lejohet të lidhë marrëveshje pagese me këste.

2) Tatimpaguesi paraqet një kërkesë me shkrim për të hyrë në një marreveshje pagese me këste. Kërkesa duhet t'i drejtohet drejtorit të drejtorise rajonale apo njesive te ngjashme me to dhe duhet të parashtrojë arsyet që e pengojnë tatimpaguesin për të paguar detyrimet e tij tatimore.

3) Marrëveshja e pagesës me këste bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga drejtori i drejtorisë rajonale apo drejtuesi i njesive te ngjashme me to dhe tatimpaguesit.

4) Marrëveshja i pagesës me këste nuk mund të zgjasë më tepër se fundi i vitit kalendarik pasardhes.

5) Administrata tatimore mund ta refuzojë kërkesën për një marrëveshje pagese me këste, ose të kërkojë garanci bankare para se të hyjë në një marrëveshje të tillë.

6) Tatimpaguesi duhet të paguajë kamatëvonesë për gjithë detyrimet tatimore, pagesa e të cilave shtyhet sipas marrëveshjes së pagesës me këste.

**Neni 78**
**Zgjidhja e marreveshjes së pageses me këste**

1) Marreveshja e pagesës me këste zgjidhet nga administrata tatimore kur:

a) tatimpaguesi nuk bën pagesat në përputhje me marreveshjen; ose
b) tatimpaguesi nuk paguan detyrimet e tjera tatimore që lindin gjatë periudhës së mbuluar nga marreveshja.

2) Nëse marreveshja e pagesës me këste zgjidhet, gjithë detyrimet tatimore të papaguara që mbulohen nga kjo marreveshje paguhen brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit të zgjidhjes se marreveshjes.

**Neni 79**
**Radha e pagesës**
**së detyrimeve tatimore dhe kontributeve**

1) Pagesat e detyrimeve tatimore shlyejnë detyrimet sipas radhës që vijon:

a) kostot administrative;
b) gjoba e vlerësuar;
c) kamatvonesa;
d) tatimi i vlerësuar.

2) Kostot administrative llogariten ne perputhje me rregullat e miratuara me udhezim te Ministrit te Financave

3) Radha e pagesës për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është si vijon:

a) kontributet e punëmarrësit;
b) kontributet e punëdhënësit.

## KREU X
## KONTROLLI TATIMOR

**Neni 80**
**Kontrolli tatimor**

1) Administrata tatimore kontrollon deklaratat tatimore, llogaritë, librat dhe regjistrimet tatimore të tatimpaguesit, përfshi gjithë dokumentacionin që ka të bëjë me të ardhurat, shpenzimet, aktivet dhe pasivet dhe marrëdhëniet financiare me palë të treta.

2) Kontrolli i tatimpaguesit bazohet në deklaratat e dhëna nga tatimpaguesi si dhe në librat, regjistrimet dhe informacionin e dhënë nga palët e treta ose në përputhje me metodat alternative të vlerësimit parashikuar në nenin 72 të këtij ligji.

3) Administrata tatimore kontrollon saktësinë e gjithë dokumentave që kanë të bëjnë me statusin ligjor, rezidencën, veprimtarinë ekonomike, pagesat dhe detyrimet tatimore si dhe çdo dokument tjetër me rëndësi për përcaktimin e detyrimit tatimor.

4) Zgjedhja e tatimpaguesve që kontrollohen, bëhet në bazë të analizës së vlerësimit të riskut që administrata tatimore kryen për të identifikuar tatimpaguesin që ka më shumë rrezik per të ketë shkelur legjislacionin tatimor.

5) Kontrollet që kryhen nga administrata tatimore qendrore urdherohen nga drejtori i drejtorise rajonale e tatimeve apo i njesive te ngjashme me to. Kontrollet që kryhen nga administrata tatimore vendore, urdherohen nga titullari i zyra tatimore te qeverisjes vendore.

6) Procedurat për kryerjen e kontrolleve tatimore, si dhe llojet e kontrolleve tatmore, miratohen nga ministri i Financave me propozim te drejtorit te pergjithshem te tatimeve.

**Neni 81**
**Njoftimi i kontrollit tatimor**

1) Administrata tatimore i dërgon tatimpaguesit njoftimin i cili përcakton tatimpaguesin si subjekt të kontrollit tatimor.

2) Njoftimi i kontrollit tatimor përmban:

a) identifikimin e organit që kryen kontrollin tatimor;
b) emrin dhe mbiemrin e tatimpaguesit person fizik, ose emrin e personit juridik, subjekt kontrolli;
c) numrin e identifikimit të tatimpaguesit;
d) datën e leshimit;
e) bazën ligjore për kontrollin:
f) llojet e tatimit subjekt i kontrollit;
g) periudhën ose periudhat tatimore për të cilat kryhet kontrolli tatimor;
h) një përshkrim të të drejtave dhe detyrave të tatimpaguesit gjatë kontrollit tatimor; përfshi të drejtën e ankimit të vlerësimit që bëhet në bazë të kontrollit tatimor;
i) datën dhe orën kur fillon kontrolli tatimor;
j) vendin e kontrollit tatimor;
k) nënshkrimin e titullarit të zyrës ; dhe
l) një kërkesë për vënien në dispozicion të administratës tatimore të informacionit specifik në lidhje me kontrollin tatimor.

**Neni 82**
**Përjashtimi i inspektorit**
**nga kontrolli tatimorë**

1) Nepunesit e administratës tatimore te lidhur me tatimpaguesin subjekt kontrolli, nuk mund të marrin pjesë në kontrollin e atij tatimpaguesi.

2) Në këta punonjës të lidhur përfshihen:

a) nepunesi i lidhur me tatimpaguesin që është subjekt kontrolli, me lidhje gjaku deri ne shkallen e trete;

b) nepunesi qe vepron si përfaqësues i tatimpaguesit që është subjekt kontrolli si dhe
c) nepunesi qe eshte i lidhur me marrveshje biznesi me tatimpaguesin që është subjekt kontrolli.

**Neni 83**
**Raporti i kontrollit tatimor**

1) Inspektori i grupit te kontrollit tatimor është përgjegjës për përgatitjen e raportit të kontrollit brenda shtate ditëve kalendarike pas përfundimit të kontrollit tatimor.

2) Raporti i kontrollit jep rezultatet e kontrollit, shumën e vlerësimit të propozuar dhe referencat ligjore qe justifikojne propozimin e bere dhe nënshkruhet nga inspektori / inspektoret e kontrollit tatimor.

3) Një kopje e raportit të kontrollit i jepet drejtorit te drejtorise rajonale të tatimeve dhe një kopje e raportit i dërgohet me postë tatimpaguesit.

4) Tatimpaguesi ka të drejtë t'i kundërshtojë rezultatet e kontrollit tatimor brenda tre ditëve pune pas datës që raporti konsiderohet të jetë marrë nga tatimpaguesi.

5) Kundërshtimi nga tatimpaguesi bëhet me shkrim dhe ne të përshkruhen arsyet e kundërshtimit.

6) Grupi i kontrollit e shqyrton kundërshtimin brenda 5 ditëve pune pas datës që kundërshtimi është marre ose konsiderohet të jetë marrë dhe arsyetimi i dhene nga grupi i kontrollit për kundërshtimin, përfshihet në raportin përfundimtar të kontrollit.

**Neni 84**
**Raporti përfundimtar**
**i kontrollit tatimor**

1) Raporti përfundimtar i kontrollit tatimor plotësohet dhe nënshkruhet nga të gjithë pjestarët e grupit të kontrollit, dhe miratohet nga urdheruesi i kontrollit, brenda 14 ditëve kalendarike nga data që kundërshtimi i tatimpaguesit është marrë ose konsiderohet të jetë marrë nga grupi i kontrollit tatimor.

2) Raporti përfundimtar i kontrollit tatimor përshkruan vendin e kontrollit, periudhën për të cilën është kryer kontrolli, një përshkrim të dokumentave të shqyrtuara, personat e intervistuar, arsyetimi i tatimpaguesit qe eshte marre ne konsiderate dhe rezultatin e argumentuar të kontrollit.

3) Një kopje e raportit përfundimtar të kontrollit tatimor dhe shuma e vlerësimit, nëse ka, i dërgohet me postë tatimpaguesit dhe një kopje dorëzohet në drejtorinë rajonale tatimore apo njesine e ngjashme me te.

4) Nëqoftëse raporti perfundimtar i kontrollit tatimor propozon një vlerësim të ri, ky vlerësim hyn në fuqi 30 ditë kalendarike nga data që raporti i kontrollit është marre ose konsiderohet të jetë marrë nga tatimpaguesi.

5) Tatimpaguesi që kundërshton vlerësimin e propozuar, mund ta ankimoje këtë vlerësim në përputhje me dispozitat e Kreut XIII të këtij ligji.

**Neni 85**
**Rikontrolli tatimor**

1) Rezultatet e kontrollit tatimor janë detyrues për administratën tatimore. Për të njëjtin detyrim tatimor, nuk mund të kryhen kontrolle të mëtejshme, me perjashtim te rasteve kur:

a) tatimpaguesi nuk ka bashkëpunuar gjatë kontrollit tatimor ose nuk ka vepruar në përputhje me kërkesën me shkrim për dhënien e informacionit administratës tatimore gjatë kryerjes së kontrollit tatimor;
b) administrata tatimore ka prova konkrete dhe të besueshme që tatimpaguesi është përfshirë në evazion tatimor apo
c) inspektori gjate kontrollit tatimor nuk ka vepruar ne perputhje me procedurat e kontrollit dhe per kete shkak ndaj tij kane filluar procedura disiplinore apo jane marre masa disiplinore. Ne perberjen e grupit te rikontrollit tatimor nuk mund te bejene pjese inspektore qe kane marre pjese ne kontrollin tatimor te meparshem

2) Rikontrolli tatimor miratohet nga drejtori i përgjithshëm i tatimeve sipas me shkrim për fillimin e një rikontrolli tatimor, te bere nga drejtori i drejtorise rajonale apo i njesive te ngjashme me to si dhe te drejtoreve drejtorive te kontrollit apo auditit brenda drejtorise se pergjithshme.

**Neni 86**
**Bashkëpunimi**
**me ekspertët e jashtëm**

1) Në rastet kur punonjësve të administratës tatimore u mungon ekspertiza e duhur, për të kontrolluar dhe vlerësuar korrektësisht detyrimin tatimor të një tatimpaguesi, administrata tatimore mund të kërkojë asistencë teknike nga ekspertë në fusha të veçanta,.

2) Ekspertit te jashtem, te kontraktuar nga administrata tatimore, mund t'i jepet vetëm informacioni teknik përkatës. Eksperti i jashtem është subjekt i të njëjtave rregulla të ruajtjes së konfidencialitetit si për të gjithë nepunesit e administratës tatimore.

**Neni 87**
**Asistenca e huaj**

1) Administrata tatimore mund të kërkojë asistencën e një autoritet tatimor të huaj për zgjidhjen e çeshtjeve tatimore të veçanta.

2) Asistenca e huaj kërkohet në bazë të marrëveshjeve tatimore dypalëshe ose shumëpalëshe. Në mungesë të marrëveshjeve të tilla, asistenca kërkohet në bazë të parimit të reciprocitetit me kusht qe:

a) informacioni i dhene do te jete subjekt i te njejtave rregulla të ruajtjes së konfidencialitetit sipas këtij ligji; dhe
b) informacioni i marre do te perdoret në përputhje me këtë ligj për qëllimin e vetëm të zbatimit të legjislacionit tatimor.

## KREU XI
## MBLEDHJA ME FORCE E DETYRIMIT TATIMOR TË PAPAGUAR

### Neni 88
### Autoriteti dhe kompetencat për mbledhjen e detyrimit tatimor të papaguara

1) Administrata tatimore ka autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kreu për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara per te cilat nuk eshte ushtruar e drejta e ankimit apo kane kaluar te gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqesor.

2) Administrata tatimore i ushtron këto kompetenca duke zbatuar metodat e vlerësimit të riskut, për të përcaktuar dhe zbatuar në çdo rast masen më të përshtatshme të mbledhjes me forcë, në mënyrë që të maksimalizojë mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara.

3) Kriteri i vlerësimit të riskut bazohet në dokumentacionin financiar të dhënë nga tatimpaguesi ose palët e treta, duke marrë parasysh shumën e detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit dhe aftësinë e tij për të paguar tatimin.

### Neni 89
### Njoftimi dhe kërkesa për të paguar

1) Sa herë që administrata tatimore gjykon që një tatimpagues nuk ka paguar plotësisht dhe në datën e caktuar detyrimet e tij tatimore, administrata tatimore i dërgon me postë rekomande tatimpaguesit, një njoftim me shkrim, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimit tatimor. Per njoftimin dhe kerkesen per te paguar zbatohen te njejtat afate dhe procedura siç parashikohet në nenin 69 të këtij ligji.

2) Nëse tatimpaguesi nuk perdor te drejten e tij te ankimit dhe nuk paguan detyrimin e tij tatimor, administrata tatimore duhet të mbledhë tatimin duke perdorur njeren ose disa prej metodave të parashikuara sipas këtij kreu.

3) Detyrimi për dergimin e njoftimit dhe kërkesës per te paguar nuk zbatohet, nëse administrata tatimore zotëron prova konkrete dhe të besueshme se tatimi eshte ne rrezik dhe tatimpaguesi për të shmangur mbledhjen me forcë të detyrimit të tij tatimor, mund të kërkojë të fshehë ose transferojë aktivet e tij.

4) Ne rastin e parashikuar ne paragrafin e trete te ketij neni, administrata tatimore ne perputhje me dispozitat e Kodit Penal dhe Kodit Procedural Penal, mund te kerkoje pane organeve kompetente:

a) ndalimin e levizjes jashte territorit te Republikes se Shqiperise, te administratorit te personit juridik, ortakut dhe aksionarit te personit juridik apo individit tregtar, i cili ka detyrime te papaguara;
b) ndalimin e transferimit jashte shtetit te shumave te depozitura ne llogarite bankare ne emer te individit tregtar apo te shoqerise tregtare qe ka detyrime te papaguara.

## Neni 90
## Urdheri i bllokimit te llogarive bankare te tatimpaguesit

1) Nëqoftëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar në përputhje me nenin 89 te ketij ligji per njoftimin dhe kerkesen per pagese, administrata tatimore nepermjet nje urdheri me shkrim te leshuar nga drejtori i drejtorise rajonale apo i njesise se ngjashme me te apo titullari i zyres tatimore te qeverisjes vendore, i kerkon cdo banke ne te cilen tatimpaguesi ka llogari ne emer te vet te mbaje nje shume e cila duhet te jete me e vogla ndermjet:

a) shumes qe kerkohet te mbahet; dhe
b) shumes qe rezulton ne ate moment ne llogarine bankare te tatimpaguesit.

2) Me perjashtim te rasteve kur ligji i fushes e ka parashikuar ndryshe, nese ne banken ku tatimpaguesi ka llogarine bankare, ka edhe urdhera pagese te tjera, urdheri i leshuar nga administrata tatimore ekzekutohet i pari.

## Neni 91
## Masa e sigurimit te detyrimit tatimor

1) Nëse tatimpaguesi nuk paguan në datën e caktuar detyrimin e tij tatimor në përputhje me nenin 89 te ketij ligji, detyrimi tatimor i papaguar sigurohet në favor të administratës tatimore mbi gjithë pasurinë e tatimpaguesit, në masën e nevojshme për të përmbushur detyrimin e tij tatimor.

2) Masa e sigurimit te detyrimit tatimor te papaguar mund të jetë barrë siguruese dhe/ose barre hipotekare sipas rastit. Vendimi për të vendosur një barrë siguruese dhe/ose barrë hipotekare mbi pasurinë e tatimpaguesit bëhet me shkrim nga drejtori i drejtorise rajonale tatimore apo i njesive te ngashme me to ose titullarit të zyrës tatimore të qeverisjes vendore.

3) Para vendosjes së një barre siguruese dhe/ose barrë hipotekare mbi pasurinë e tatimpaguesit, ky i fundit duhet të njoftohet me shkrim për vendosjen e sigurimit dhe njoftimi duhet të përfshijë gjithë informacionin lidhur me to.

5) Njoftimi për barrën siguruese dhe/ose barrën hipotekare duhet të përmbajë të dhënat e nevojshme që nevojiten për të identifikuar tatimpaguesin, detyrimin tatimor të papaguar, pasurinë subjekt i barrës siguruese dhe/ose barren hipotekare dhe kompetencën e administratës tatimore për të dorëzuar kërkesë për vendosjen e tyre.

6) Formati i njoftimit për barrën siguruese dhe/ose barrën hipotekare dhe rregjistrat publik per rregjistrimin e tyre parashikohen në vendimin e Keshillit të Ministrave në zbatim të këtij ligji.

7) Nëse plotësohen të gjitha kërkesat në fuqi për njoftimin dhe dorëzimin e kërkesës për vendosjen e mases se sigurimit te detyrimit tatimor të papaguar ne favor të administratës tatimore, barra siguruese dhe/ose barra hipotekare është e vlefshme kundrejt gjithë të drejtave të tjera mbi pasurinë subjekt i sigurimit të detyrimit tatimor të papaguar dhe ka përparësi mbi gjithë të drejtat e tjera të dorëzuara në lidhje me këtë pasuri.

**Neni 92**
**Ankimimi**
**i mases se sigurimit te detyrimit tatimor**

1) Tatimpaguesi ka të drejtë të ankimoje vendimin për masen e sigurimit te detyrimit tatimor të papaguar tek drejtori i drejtorise rajonale tatimore apo i njesive te ngjashme me to, dhe te kerkoje çlirimin nga sigurimi, vetem kur ky i fundit është ekzekutuar në mënyrë të parregullt. Ankimi bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga momenti i marrjes dijeni për këtë parregullsi.

2) Kur kërkesa e tatimpaguesit miratohet nga drejtori i drejtorise rajonale tatimore apo i njesive te ngjashme me to, ky i fundit, mbi bazën e një vendimi të marrë me shkrim, ndërmerr menjëhere të gjitha masat e nevojshme sipas legjislacionit përkates në fuqi për çbllokimin e masës së sigurimit mbi pasurine e tatimpaguesit dhe e vendos vendimin në dosjen e tatimpaguesit. Nëqoftëse drejtori i drejtorise rajonale tatimore apo i njesive te ngjashme me to, nuk miraton kërkesën e tatimpaguesit, tatimpaguesi mund ta ankimoje këte vendim në përputhje me kreun XIII të këtij ligji.

**Neni 93**
**Sekuestrimi i pasurisë**

1) Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar në përputhje me nenin 89 te ketij ligji per njoftimin dhe kerkesen per pagese, administrata tatimore mund të mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nepermjet sekuestrimit te pasurinë se siguruar në favor te administrates tatimore, në pronësi të tatimpaguesit.

2) Ekzekutimi i mases se sigurimit nëpërmjet sekuestrimit dhe shitjes së pasurisë sipas këtij kreu, është subjekt i dispozitave të ligjit "Për kundravajtjet administrative" të cilat ekzekutohen nga administrata tatimore.

3) Urdhëri për sekuestrimin e pasurisë bëhet me shkrim nga drejtori i drejtorise rajonale tatimore ose titullari i zyrës tatimore te qeverisjes vendore. Urdheri duhet të identifikojë tatimpaguesin, pasuria e të cilit është subjekt i sekuestrimit , vendndodhjen e pasurisë dhe vlerësimin e tatimit për të cilin vihet sekuestro. Urdheri i dërgohet tatimpaguesit me postë rekomande.

4) Administrata tatimore mund të sekuestrojë pasurinë sipas detyrimit vetëm pas vendosjes së mases së sigurise mbi pasurinë në përputhje me nenin 91 te ketij ligji dhe vetëm 30 ditë kalendarike pas datës kur urdhri i sekuestrimit është marre ose konsiderohet të jetë marrë nga tatimpaguesi në formën e parashikuar nga neni 94 i këtij ligji.

5) Nëse administrata tatimore konstaton se mbledhja e tatimit është në rrezik, mund të dërgoje njoftim dhe kërkesë për pagesën e menjëherëshme të këtij tatimi dhe, nëqoftëse detyrimi tatimor nuk paguhet plotësisht, administrata tatimore ka kompetencë të bëjë sekuestrimin pavarësisht nga afatet e parashikuara në këtë nen.

**Neni 94**
**Urdhëri i sekuestrimit**

1) Urdhëri i sekuestrimit përmban:
a) shumën e detyrimeve tatimore të papaguara;
b) afatin për pagesën e detyrimeve tatimore;
c) pasurinë që sekuestrohet;
d) metodën për ekzekutimin e sekuestrimit; dhe
e) informacionin rreth të drejtës së tatimpaguesit për ankim administrativ.

2) Nëqoftëse subjekti i sekuestrimit është paga e tatimpaguesit, urdhëri përfshin edhe emrin dhe adresën e punëdhënësit të tij.

**Neni 95**
**Pasuria subjekt i sekuestrimit**

1) E gjithe pasuria e tatimpaguesit eshte subjekt i sekuestrimit ne masën e detyrimit tatimor te papaguar, pervec sendeve te percaktuara ne nenin 529 te Kodit te Procedurave Civile.

**Neni 96**
**Shitja e pasurisë së sekuestruar**

1) Pasuria e sekuestruar shitet në ankand publik, kryer në përputhje me procedurat dhe kushtet e parashikuara në ligjin per ankandin publik.

2) Të ardhurat nga shitjet përdoren fillimisht për të paguar shpenzimet e shitjes, me pas për të paguar koston administrative, gjobat, interesin dhe tatimin në përputhje me nenin 79 të këtij ligji.

3) Shuma e mbetur i kthehet tatimpaguesit brenda pesë ditëve pune pas perfundimit te ankandit.

**Neni 97**
**Transferimi i detyrimit tatimor**
**tek pala e trete**

1) Në rastet kur shuma e të ardhurave nga shitja e pasurisë së sekuestruar tatimpaguesit, nuk mbulon gjithë shumën e detyrimit

tatimor të papaguar, administrata tatimore mund të nxjerrë një njoftim për palët e treta me të cilin urdhëron, pagesën e drejtpërdrejtë, brenda 14 ditëve kalendarike, të një shume të barabartë me vlerën e pasurisë së transferuar nga tatimpaguesi tek pala e tretë, kur ky transferim është kryer pas nxjerrjes së njoftimit të sekuestrimit të pasurisë nga administrata tatimore.

2) Përgjegjësia e palës së tretë kufizohet në vlerën e tregut të pasurisë së transferuar nga tatimpaguesi tek pala e tretë.

3) Në rastet kur detyrimi tatimor i një tatimpaguesi qe eshte person juridik, mbetet i pashlyer edhe pas shitjes së pasurisë së sekuestruar, personi që, gjatë tre vjetëve para nxjerrjes së njoftimit të sekuestrimit, ka transferuar nga tatimpaguesi shoqeri tregtare, te drejtat mbi pasurine, nëpermjet një transaksioni të kryer me vlere dukshem me te vogel se vlera e tregut, është në radhë te dytë përgjegjës për detyrimin tatimor të tatimpaguesit, deri në vlerën e te drejtave te transferuara, duke zbritur shumën e paguar nga personi për këtë pasuri.

**Neni 98**
**E drejta e për të kërkuar detyrimet nga pala e treta**

1) Administrata tatimore mund ti kerkoje palës së tretë që të kryej pagesën e drejtpërdrejtë të çdo shume që kjo pale e tretë i detyrohet tatimpaguesit, brenda 30 ditë kalendarike nga dita e dërgimit të njoftimit kësaj pale të tretë.

2) Njoftimi dhe kërkesa për të paguar bëhen në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara në nenin 69 të këtij ligji.

3) Nëqoftëse pala e tretë nuk paguan shumën që duhet paguar brenda afatit të caktuar, atehere ndaj saj administrata tatimore mund të fillojë procedurat e mbledhjes me forcë, parashikuar sipas këtij kreu.

**Neni 99**
**Përgjegjësia e ortakut, aksionarit dhe administratorit**

1) Nëqoftëse, edhe pas shitjes së pasurisë së sekuestruar me qellim shlyerjen e detyrimit tatimor, detyrimet tatimore të një personi juridik nuk shlyhen plotësisht, detyrimi tatimor i mbetur transferohet per llogari te ortakut, aksionarit dhe administratorit ne perputhje me nenin 16 te ligjit "Per sipermarresit dhe shoqerite tregtare".

2) Administratori dhe ortaket apo aksionaret, janë solidarisht përgjegjës për detyrimin tatimor të papaguar të personit juridik.

3) Rregullat e parashikuara ne paragrafin e pare dhe te dyte te ketij neni vlejne edhe per rastet kur ne perfundim te procesit te likujdimit apo falimentimit te tatimpaguesit shoqeri tregare ka mbetur ende detyrim tatimor i pashlyer.

## Neni 100
## Parashkrimi i të drejtes për fillimin e proçedurave të zbatimit të masave shtrënguese

1) E drejta për fillimin e proçedurave për zbatimin e masave shtrënguese, sipas këtij kreu, parashkruhet brenda 6 viteve nga data kur detyrimi tatimor i papaguar duhej kryer.

2) Afati i parashkrimit parashikuar në paragrafin e pare të këtij neni ndërpritet në rastet e mëposhtme:

a) gjatë ankimimit kundër detyrimit tatimor në fjalë;
b) gjatë periudhës kur detyrimi tatimor në fjalë është subjekt i një kontrolli ose hetimi zyrtar nga administrata tatimore; dhe
c) gjatë periudhës kur detyrimi tatimor në fjalë është subjekt i një çeshtjeje penale.

## Neni 101
## Detyrimi per t'u paraqitur

1) Administrata tatimore ka të drejtë të thërrasë çdo person në rastet kur ajo gjykon se prania e personit është e nevojshme për zbatimin e duhur të legjislacionit tatimor.

2) Administrata tatimore ka të drejtë të thërrasë çdo person për të dëshmuar, dhënë ekspertizë, ose për të paraqitur librat dhe regjistrimet, në rastet kur informacioni i kërkuar nuk mund të dërgohet lehtësisht dhe pa shpenzime të mëdha me postë ose në mënyrë elektronike.

3) Kërkesa e administrates tatimore per tu paraqitur, bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga drejtori i drejtorise rajonale tatimore ose titullari i zyrës tatimore te qeverisjes vendore dhe përmban:

a) identifikimin e zyrës tatimore qendrore ose vendore që nxjerr kërkesen për paraqitje;
b) emrin dhe identifikimin tatimor të personit të thirrur;
c) vendin, datën dhe orën e paraqitjes;
d) subjektin e kerkeses dhe cilësinë e personit të thirrur (tatimpagues, palë e tretë, ose ekspert); dhe
e) një listë të librave dhe regjistrimeve specifike, dhe dokumenteve të tjera që personi duhet të dorëzojë.

4) Kërkesa për paraqitje dërgohet me postë rekomande të paktën 15 ditë kalendarike para datës së caktuar për paraqitje.

5) Personi thirret gjatë orarit të zyrtar të punës, përveç rasteve kur masa të jashtëzakonshme dhe urgjente kërkojnë që procedura të kryhet jashtë orarit zyrtar të punës.

6) Mosparaqitja në përputhje me kërkesën e administrates tatimore ndëshkohet me gjobe ndaj personit të thirrur .

7) Procedura e thirrjes shtyhet vetëm për shkaqe të arsyeshme që paraqiten në një kërkesë me shkrim të tatimpaguesit.

**Neni 102**
**Nderprerja e procedurave**
**te mbledhjes me force te detyrimit tatimor**

1) Administrata tatimore nderpret menjehere zbatimin e masave shtrenguese të sigurimit të detyrimit tatimor parashikuar në këtë ligj:

a) kur tatimpaguesi shlyen plotësisht gjithë detyrimet tatimore;
b) pas mbarimit të afatit të parashkrimit sipas nenit 100 të këtij ligji, ose
c) pas deklarimit te pambledhshem të detyrimit tatimor ose
d) detyrimi tatimor falet me ligj te veçante.

**Neni 103**
**Procedurat për deklarimin e detyrimit tatimor**
**si të pambledhshëm**

1) Deklarimi i nje pjese apo i te gjithe detyrimit tatimor si te pambledhshem behet duke u bazuar në parimet që vijojnë:

a) deklarimi i pambledhshem i tatimit, interesit dhe gjobes të një tatimpaguesi mund te behet pasi të jenë zbatuar dhe evidentuar te gjithë procedurat e mbledhjes sipas ketij ligji, duke përfshirë: (i) shitjen e investimeve likuide, dhe aktiveve të tjera jo thelbësore për vazhdimin e veprimtarisë ekonomike (ii) negociimin e një plani të pagesës me këste; dhe (iii) kreyerjes së vlerësimit që falimentimi ose likuidimi nuk do të çonin në një rezultat më të mirë;
b) vendimi për deklarimin si te pabledhshem i të gjithë ose të një pjese të një detyrimit tatimor, duhet të marrë në konsideratë mundësitë reale të mbledhjes, dhe nëqoftëse ndërmarrja e veprimeve të mëtejshme të mbledhjes së plotë të detyrimit tatimor përbën mënyrën më eficiente të përdorimit të burimeve të mbledhjes së administratës tatimore, për realizimin e objektivit të maksimalizimit të mbledhjes totale të tatimeve sipas ligjit.

2) Per klasifikimin si te pambledhshem te një pjese ose të të gjithë detyrimit tatimor, tatimpaguesi duhet të bëjë një kërkesë me shkrim prane drejtorit te pergjithshem te tatimeve. Kekrkeses i bashkelidhet dokumentacion i plote lidhur me të gjithë aktivet dhe pasivet e tij, duke përfshirë:

a) të ardhurat dhe shpenzimet ne menyre te detajuar;
b) parashikimet e fluksit të parasë;
c) vlerësimet e aktiveve;
d) deklaratat e fitimeve dhe humbjeve dhe bilancet;
e) listat e debitorëve dhe kreditorëve, dhe një vlerësim të mundësisë për mbledhjen e borxheve.

3) Deklarimi i pambledhshem i të gjithë ose një pjese të një detyrimi tatimor nuk mund të bëhet kur ka prova të evazionit tatimor ose mashtrimit.

4) Deklarimi i pambledhshem i detyrimit tatimor apo i nje pjese te tij behet me vendim te drejtorit te pergjithshem te tatimeve.

5) Deklarimi i pambledhshem i detyrimit tatimor apo i nje pjese te tij per shuma te barabarta apo me te medha se 5.000.000 lekë, bëhet me urdher te Ministrit të Financave, sipas dokumentacionit dhe rekomandimit te dhne nga administrata tatimore.

6) Administrata tatimore publikon çdo vit vlerën totale të detyrimeve tatimore të deklaruara si te pambledhshme, numrin e kërkesave te bera dhe numrin e kërkesave të pranuara.

**104**
**Fillimi i procedurave te falimentimit**

1) Administrata tatimore kerkon ne gjykate fillimin e procedures se falimentimit per tatimpaguesit shoqeri tregtare qe:

a) kalojne ne statusin pasiv nga qendra kombetare te rregistrimit;
b) detyrimi tatimor i tyre eshte deklaruar i pambledhshem;
c) deklarojne rezultat me humbje per te pakten tre vite rresht;
d) nuk kane kryer veprimtari tregtare per nje periudhe prej te pakten 2 vitesh nga dita e hyrjes ne fuqi te ketij ligji;
e) kane detyrime te pashlyera ndaj administrates tatimore prej te pakten 2 vitesh nga hyrja ne fuqi e ketij ligji.

2) Tatimpaguesit shoqeri tregtare, per te cilat administrata tatimore ka kerkuar filllimin e procedurave te falimentimit, publikohen ne faqen zyrtare te drejtorise se pergjithshme te tatimeve.

3) Mosfillimi i procedures se falimentimit te tatimpaguesve shoqeri tregtare, brenda gjashte muajve nga verifikimi i njerit prej kushteve te parashikuara ne paragrafin e pare te ketij neni, nga nepunesit e administrates tatimore, qe konstatojne apo kane per detyre te konstatojne verifikin e faktit juridik, perben shkelje disiplinore.

## KREU XII
## HETIMI TATIMOR

### Neni 105
### Struktura dhe funksionet e njesive të hetimit tatimor

1) Strukturat e hetimit tatimor jane njesi specializuara te hetimit dhe zbatimit në administratës tatimore qendrore.

2) Strukturat e hetimit tatimor kane si funksion parësor:

1- mbledhjes e informacionit tatimor;
2- hetimin tatimor dhe
3- ndjekjen dhe zbatimin e masave shtrenguese.

3) Punonjesit e njesive të hetimit tatimor gëzojnë atributet e policise gjyqësore në përputhje me Kodin e Procedurave Penale dhe ligjin për organizimin dhe funksionim e policise gjyqësore.

4) Punonjësit e struktura te hetimit tatimor qe ushtrojne funksionet e ndjekjes dhe ekzekutimit te masave shtrenguese, pajisen me armë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5) Detyrat dhe funksionet e drejtorisë së hetimit tatimor në zbatim të këtij neni, përcaktohen me vendim të Keshillit të Ministrave.

## KREU XIII
## ANKIMIMI ADMINISTRATIV TATIMOR

### Neni 106
### Subjekti i ankimit administrativ tatimor

1) Tatimpaguesi mund të ankimojë kundër çdo njoftim vleresimi, çdo vendimi që ndikon në detyrimin e tij tatimor, kërkese për rimbursim ose lehtësim tatimor, ose çdo akti ekzekutiv te posaçem tatimor ne lidhje me tatimpaguesin.

2) Ankimi bëhet me shkrim dhe në formën e parashikuar në zbatim të këtij ligji, me udhezim te Ministrit te Financave.

3) Tatimpaguesi e dorëzon ankimin në drejtorinë e apelimit tatimor brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur vlerësimi, ose vendimi i administratës tatimore, është marrë ose konsiderohet të jetë marrë nga tatimpaguesi.

4) Drejtoria e apelimit i dërgon një kopje të ankimit administratës tatimore që ka nxjerrë vlerësimin tatimor ose vendimin që është subjekt i ankimit tatimor.

### Neni 107
### Pagesa e detyrimit tatimor subjekt i ankimit

1) Tatimpaguesi i cili kerkon të ankimojë sipas paragrafit te pare të nenit 106 të këtij ligji, duhet qe bashke me ankesen të paguajë shumën e plotë të detyrimit tatimor të përcaktuar në njoftim vlerësimin e administratës tatimore.

2) Shuma e pagueshme sipas paragrafit te pare të këtij neni përjashton gjithë kamatëvonesat ose gjobat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar.

3) Ankimi merret në shqyrtim, vetëm kur tatimpaguesi ka paguar detyrimin tatimor qe eshte subjekt i ankimit.

4) Akti administrativ i leshuar nga administrata tatimore dhe per te cilin nuk eshte ankimuar ne rruge administrative, nuk mund te ankimohet ne rruge gjyqesore.

5) Perpara se te depozitoje kerkese-padine per shqyrtimin gjyqesor, tatimpaguesi duhet te paguaje 15 % te vleres se gjobave.

### Neni 108
### Kompetenca
### për shqyrtimin e ankimit tatimor

1) Drejtoria e apelimit tatimor shqyrton ankimin tatimor dhe merr vendim në bazë të provave dhe argumenteve të paraqitura nga tatimpaguesi dhe administrata tatimore.

2) Drejtoria e apelimit tatimor ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë nga tatimpaguesi ose administrata tatimore.

3) Drejtoria e apelimit pas shqyrtimit të ankimit vendos:
a) lënien në fuqi të aktit subjekt ankimi dhe rrëzimin e ankimit;
b) shfuqizimin/revokimin e aktit subjekt ankimi;
c) ndryshimin e aktit subjekt ankimi duke pranuar pjesërisht ankimin.

4) Tatimpaguesi ka të drejtë ta paraqesë personalisht çeshtjen e tij para drejtorisë së apelimit tatimor ose të caktojë një përfaqësues për ta përfaqësuar para kësaj drejtorie.

5) Barra e provës për të vërtetuar që një vlerësim tatimor ose vendim është i pasaktë bie mbi tatimpaguesin.

6) Vendimi i drejtorisë së apelimit tatimor duhet të përfshijë një shpjegim me shkrim të bazës për vendimin e marrë prej saj, duke perfshire arsyetimin në respektim edhe të dispozitave të nenit 108 te Kodit të Procedurave Administrative.

**Neni 109**
**Vendimi i drejtorise**

1) Vendimi i drejtorisë së apelimit tatimor vendoset në dosjen e tatimpaguesit dhe nje kopje i dërgohet me postë rekomande tatimpaguesit dhe organit të administratës tatimore që ka bërë vlerësimin tatimor ose ka marrë vendimin që është subjekt i ankimit.

2) Tatimpaguesi mund të kundërshtoje vendimin e drejtorise së apelimit tatimor në gjykatë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të këtij vendimi. Nëse drejtoria e apelimit tatimor nuk shprehet brenda tre muajve nga data e marrjes së ankimit, tatimpaguesi mund të ankohet drejtpërdrejte në gjykatë me kushtin qe te kete paguar paraprakisht 15 % te vleres se çdo gjobe.

3) Administrata tatimore e cila ka nxjerre vendimin administrativ subjekt ankimi, mund të apeloje vendimin e drejtorise së apelimit tatimor në gjykate brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të kētiij vendimi.

4) Për rivendosjen në afat, zbatohen proçedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

**Neni 110**
**Rimbursimi i detyrimit tatimor,**
**pagesa e kamatëvonesës dhe gjobës**

1) Nëse vendimi i drejtorisë së apelimit tatimor është në favor të tatimpaguesit dhe administrata tatimore e pranon vendimin, detyrimi tatimor i paguar më tepër nga tatimpaguesi dhe kamatëvonesa mbi tatimet e paguara më tepër, llogaritur nga data e pagesës së detyrimit tatimor deri në datën e rimbursimit, i rimbursohen tatimpaguesit brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur është marre ose konsiderohet të jetë marrë vendimi i drejtorisë së apelimit të tatimor.

2) Nëse drejtoria e apelimit tatimor lë në fuqi vendimin e administratës tatimore, kamatëvonesa, e llogaritur nga data e nxjerrjes së vlerësimit tatimor fillestar deri kur kamatëvonesa paguhet dhe çdo gjobë, paguhet nga tatimpaguesi brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur vendimi i drejtorisë së apelimit tatimor është marre ose konsiderohet të jetë marrë.

3) Njesite e administrates tatimore te perfshira ne shqyrtimin administrativ te aktit, mund të ankohet në gjykate kundër vendimit të drejtorisë së apelimit tatimor sipas afateve të parashikuara në nenin 107 të këtij ligji.

## KREU XIV
## SANKSIONET

### Neni 111
### Dënimet administrative

1) Çdo veprim ose mosveprim i tatimpaguesit, agjentit tatimor ose përfaqësuesit të tatimpaguesit, që bie në kundërshtim me ligjin dhe për të cilin ky ligj parashikon dënim administrativ, përbën shkelje tatimore administrative.

2) Shkeljet e ligjit që parashikohen per lëvizjen e mallrave nëpërmjet kufirit doganor të Shqipërisë dënohen në përputhje me legjislacionin doganor të Shqipërisë.

3) Shkeljet e ligjit qe parashikohen per mallrat e akcizes, zbatohen ne per perputhje me ligjin per akcizat.

4) Gjobat e vendosura për shkelje tatimore administrative mund të hiqen në rrethana të jashtëzakonshme kur moszbatimi i legjislacionit tatimor është shkaktuar nga fatkeqësi natyrore ose rrethana të tjera të jashtëzakonshme, siç mund të jetë vdekja ose një sëmundje e rëndë e tatimpaguesit, ose kur tatimpaguesi vepron në përputhje me udhëzimet me shkrim të administratës tatimore.

### Neni 112
### Mungesa e ekzekutimit
### te detyrimit per regjistrim

1) Perveç sanksioneve administrative te parashikuara ne ligje te tjera, mosrespektimi i detyrimit per regjistrim apo detyrimit per perditesimin e te dhenave, dënohet me gjobë te barabarte me 25.000 lek per çdo shkelje.

### Neni 113
### Mos-deklarimi në afat

1) Tatimpaguesi i cili nuk leshon deklaratën tatimore në afat dënohet me gjobë të barabartë me 10.000 lek per çdo deklarate tatimore te padorezuar.

### Neni 114

**Mos-pagimi ne afat**
**i detyrimit tatimor apo kontributetit**

1) Tatimpaguesi i cili nuk arrin qe brenda afatit te parashikuar ne kete ligj per pagese të paguajë, shumen e detyrimit tatimor, kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë të barabartë me 5 % të shumës së detyrimit te papaguar për secilin muaj apo pjesë te muajit gjate te cilit pagesa nuk eshte kryer. Ne asnje rast shuma nuk mund te jete me e vogel se 10.000 lek dhe me e madhe se 25 % te detyrimit te paraguar.

2) Për qëllime të këtij neni, shuma e papaguar e detyrimit tatimor ose kërkese te pasaktë rimbursimi është diferenca ndërmjet detyrimit tatimor që duhet paguar, ose shumës së saktë të rimbursimit, dhe shumës së tatimit të paguar apo rimbursimit të marrë në datën e caktuar

**Neni 115**
**Plotesimi i pasakte e deklarates tatimore**
**dhe kerkesa e pasakte per rimbursim**

1) Dorezimi i një deklaratë tatimore të pasaktë apo kërkese të pasaktë për rimbursim denohet me një gjobë te barabarte me 5 % te shumes se detyrimit te papaguar apo rimbursimit te kerkuar me teper, për secilin muaj apo pjesë muaji derisa shuma e detyrimit të paguhet plotësisht. Ne asnje rast shuma nuk mund te jete me e vogel se 10.000 lek dhe me e madhe se 25 % te detyrimit te papaguar.

2) Për qëllime të këtij neni, shuma e papaguar e detyrimit tatimor ose kërkese te pasaktë rimbursimi është diferenca ndërmjet detyrimit tatimor që duhet paguar, ose shumës së saktë të rimbursimit, dhe shumës së tatimit të paguar apo rimbursimit të marrë në datën e caktuar

**Neni 116**
**Evazioni fiskal**

1) Fshehja e detyrimeve tatimore, nepermjet dorëzimit te dokumentave false, deklaratave te paverteteta apo informacioneve joreale, konsiderimi i te cilave çon ne perllogaritjen e pasakte te shumes se tatimit, takses apo kontributit, perben evazion fiskal dhe denohet me gjobe te barabarte me 100% të diferences se shumes se perllogaritur nga ajo qe duhet te ishte llogaritur ne fakt.

**Neni 117**
**Dënimet për agjentët**
**e mbajtjes së tatimit në burim**

1) Çdo agjent i mbajtjes së tatimit në burim apo agjent i taksave, që nuk arrin të mbledhë tatimin në fjalë apo të japë llogari për të apo ta paguaj tatimin e tillë në datën e caktuar apo t'i shmanget pagesës së tij

, detyrohet te paguaje një gjobe te barabartë me 50 % te shumën e plotë të tatimit të pambledhur, të papaguar apo të shmangur.

**Neni 118**
**Mos-mbajtja e saktë e librave, regjistrave dhe dokumentacionit**

1) Tatimpagues që nuk arrin të mbajë regjistrat dhe dokumentacionin tatimor te kërkuar sipas ketij ligji, detyrohet te paguaje nje gjobe te barabarte me 10.000 per çdo shkelje, ne rastet kur eshte klasifikuar si biznes i vogel dhe ne rastet kur eshte klasifikuar si lloj tjeter biznesi duhet te paguaje gjobe te barabarte me 50.000 lek per çdo shkelje.

**119**
**Mos-deklarimi i te punesuarve**

1) Tatimpaguesi punedhenes i cili nuk ka deklaruar ne organin tatimor, çdo te punesuar rishtazi te pakten 48 ore perpara fillimit te punes, perveç detyrimit per pagimin e shumes se kontributeve te papaguara, detyrohet te paguaje edhe nje gjobe te barabarte me 10.000 – 20.000 lek per çdo shkelje.

**Neni 120**
**Pagesat ose arkëtimet me para në dorë mbi 300.000 lekë**

1) Tatimpaguesit qe jane persona fizikë apo juridikë tregtarë, që kryejne transaksione shitje apo blerje me para në dorë per shuma që tejkalojnë 300.000 lekë, dënohen me gjobë në masën 10% të vlerës së secilit transaksion.

**Neni 121**
**Mallrat e pashoqeruar me dokumenta tatimore**

1) Tatimpaguesi qe mban ne ruajte, përdor apo transporton mallra te pashoqeruar me dokumenta tatimore ne perputhje me dispozitat e ketij ligji, denohet me:

a) konfiskim te te gjithe sasise se mallit qe mbahej ne ruajte, përdorej apo transportohej i pashoqeruar me dokumenta tatimore ose
b) me kerkesen e tatimpaguesit masa e konfiskimit, zevendesohet me pagesen e menjehershme te nje gjobe te barabarte me vleren e tregut per te njejtin mall.

**Neni 122**
**Kundervajtjet administrative ne perdorimin e pajisjeve fiskale**

1) Tatimpaguesi person juridik denohet me gjobe nga 20.000 deri ne 100.000 leke nese:

1. nuk instaloje dhe përdorë paisjen fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dorë;
2. nuk leshon kupon tatimor për qarkullimin e realizuar të mallrave, apo shërbimet;
3. leshon nje bilete që nuk përmban elementët e përcaktuar ne kete ligj per kuponin tatimor;
4. leshon kupon tatimor ne te cilin ka vendosur nje vlere te ndryshme nga vlera e çmimit te afishuar;
5. nuk afishon në një vend të dukshëm një poster për detyrimin e blerësit të mallrave, apo përfituesit të shërbimit për të kërkuar kupon tatimor;
6. nuk mban kontrollin e gjurmës së kuponit tatimor ne ambientin e ofrimit te mallrave apo sherbimeve;
7. nuk ben faturë për qarkullimin e mallrave të realizuar, apo. shërbimeve te ofruara;
8. nuk mban libër llogarie për qarkullimin e kryer të mallrave;
9. nuk merr me qera apo nuk regjistron paisje fiskale rezervë ne rastet kur ky ligj parashikon kete detyrim;
10. nuk mban dhe mirëmban ne kushte pune paisjet fiskale.
11. nuk njofton menjehere defektin e ndodhur ne pajisjen fiskale dhe nuk ploteson ne rregull librezen fiskale te defekteve.

2) Për kundravajtjet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, drejtori përgjegjës i tatimpaguesit, denohet me gjobe nga 10.000 deri ne 30.000 leke.

3) Per kundervajtjet e parashikuara ne paragrafin e pare te ketij neni, te kryera me shume se nje here, mund te vendoset pezullimi i veprimtarise deri ne tre muaj.

4) Per kundervajtjet e parashikuara ne paragrafin e pare te ketij neni, te kryera me shume se tre here, mund te vendoset mbyllja e veprimtarise.

5) Konstatimi, shqyrtimi dhe dënimi i shkeljeve të parashikuara në këte nen bëhet nga organet tatimore dhe të policisë financiare të juridiksionit ku tatimpaguesi ushtron veprimtarinë ose kryen shkeljet.

## Neni 123
## Denimet per shoqerite e autorizuara

1) Shoqerite e autorizuara qe tregtojne pajisje fiskale denohen me gjobe te barabarte me 50.000-100.000 leke nese :

a) nuk sigurojne miratimin e Drejtorise se Kalibrimit dhe Peshmatjes perpara hedhjes ne treg te nje tipi te caktuar te kasave regjistruese;

b) nuk sigurojne mirembajtjen e pajisjeve fiskale kur jane te autorizuar per nje sherbim te tille;

c) nuk i ofron tatimpaguesit pajisje fiskale rezerve, nepermjet se ciles ai do te regjistroje xhiron, ne rastet e nderprerjes te perkohsheme te perdorimit te pajisjes fiskale te tij.

d) nuk ndryshon tipin e ndaluar te pajisjes fiskale me tipin e pershtatshem dhe te miratuar.

2) Shoqerite e autorizuara te mirembajtjes se pajisjeve fiskale denohen me gjobe te barabarte me 30.000-60.000 leke nese :

a) nuk hap skedar dhe nuk emeton librin e mirembajtjes;
b) nuk shkruan te dhenat e nevojshme ne librin e mirembajtjes;
c) nuk neneshkruan nje protokoll per marrjen persiper te mirmbajtjeas se pajisjes fiskale;
d) nuk mireman pajisjen fiskale dhe memorjen fiskale brenda kushteve te percaktuara ne autorizim;
e) nuk kryen vulosje te re te pajisjes fiskale ne prani te perfaqesuesve te administrates tatimore;
f) nuk informon administraten tatimore, ne rastet kur tatimpaguesi ka ndermarre veprime me qellim ndryshimin e te dhenave te regjistrimit te xhiros;
g) nuk informon tatimpaguesin, me te cilin ka kontrate mirembajtje rreth heqjes se autorizimit;
h) nuk merr ne dorezim te dhenat nga memorja fiskale ne prani te tatimpaguesit dhe perfaqesuesve te administrates tatimore.
i) nuk ruan memorjen fiskale ne menyren e parashikuara nga dispozitat perkatese.

## Neni 124
## Kundervajtjet ne leshimin e faturave tatimore

1) Mosleshimi i fatures tatimore apo faturës tatimore me TVSH, denohet me gjobe te barabarte me 100% të detyrimit tatimor të padeklaruar ose të papaguar si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç detyrimeve tatimore dhe interesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe ligjeve specifike tatimore.

## Neni 125
## Mospamarrja e kuponit tatimor

1) Blerës, ose përfitues i shërbimit i cili gjate kontrollit ne disnancat e parashikuara me udhezim te ministrit te financave, nga vendi i shitjes apo ofrimit te sherbimit, nuk gjendet i pajisur me kupon tatimor, denohet me gjobe te barabarte me 1.000 lek.

2) Konstatimi, shqyrtimi dhe dënimi i shkeljes së parashikuara në këte nen bëhet nga organet e administrates tatimore të juridiksionit ku kryen shkeljet.

## Neni 126
## Mosdhënia e informacionit

1) Refuzimi per dhenien e informacionit te kerkuar nga administratës tatimore ne perputhje me dispozitat e ketij ligji denohet me gjobe te barabarte me 10.000-50.000 lek per çdo shkelje.

**Neni 127**
**Pengimi i kontrollit ose hetimit tatimor**

1) Tatimpagues i cili në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë, pengon ushtrimin e te drejtave te administrates tatimore ne lidhje me kontrollin apo hetimin tatimor, denohet me nje gjobe nga 100.000 per biznesin e vogel dhe 1.000.000 lek per bizneset e tjera.

2) Te drejten per miratimin e mases se gjobes se parashikuar ne paragrafin e pare te ketij neni e ka drejtori i drejtorise rajonale apo i njesive te ngjashme me to si dhe per tatimpaguesit e klasifikuar si biznes i vogel kjo e drejte i takon titullarit te zyres tatim-taksave te qeverisjes vendore.

**Neni 128**
**Leshimi i fatures se pasakte**

1) Tatimpaguesi që lëshon fature tatimore të pasaktë e që rezulton me ulje të detyrimit, apo rritje të shumes per t'u rimbursuar denohet me gjobe te barabarte me 50 % të shumës së efektit në ulje të detyrimit tatimor, përveç detyrimeve tatimore dhe interesave të llogaritura në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjeve specifike tatimore.

2) Tatimpaguesi që lëshon një faturë tatimore me pasaktësi por që provohet se nuk ka efekt në llogaritjen dhe pagimin e detyrimit tatimor dënohet me gjobë prej 10.000 lekë.

3) Tatimpaguesi i cili nuk është subjekt i detyrimit per leshimin e fatures me TVSH, dhe lëshon fatura TVSH-je, dënohet me gjobe te barabarte me 50% TVSH-së së dhënë në faturën tatimore të paautorizuar si dhe marrjen e 100% te TVSH-se se faturuar padrejtesisht.

**Neni 129**
**Dënimet për tatimpaguesit**
**qe jane banka apo institucione financiare**

1) Shkeljet e mëposhtëme nga bankat dhe institucionet e tjera financiare që kryejnë operacione bankare, kur nuk përbejne veper penale, ndëshkohen me gjobë si vijon:

a) për hapjen e llogarive, për pagesa ose forma të tjera transsaksionesh bankare/financiare për personat fizikë dhe juridikë pa dokumentin zyrtar që konfirmon numrin e identifikimit të tatimpaguesit, në shumën 50 000 lekë për cdo shkelje;
b) për mosrespektimin e afatit të njoftimit të administratës tatimore për hapjen nga tatimpaguesi të llogarive, të pagesave ose forma të tjera transaksionesh bankare/financiare, në shumën 40 000 lekë për cdo shkelje;
c) për mostransferimin e pagesave nga tatimpaguesi në buxhet brenda një ditë pune nga dorëzimi i urdhërit të transferimit

nga tatimpaguesi, në shumën prej 125 përqind të interesit ndërbankar të Bankës së Shqipërisë të llogaritur çdo ditë deri në transferimin e pagesës në buxhet;

d) kur banka nuk mban shumen e kerkuar, ajo paguan gjobe te barabarte me 0.2 % ne dite, te detyrimit te pambajtur.

**Neni 130**
**Mosafishimi i çmimeve te shitjes**

1) Mosafishimi i çmimeve te shitjes se mallrave apo sherbimeve, denohet me gjobe te barabarte me 35.000 lek per tatimpaguesit e klasifikuar si biznes i vogel dhe 65.000 lek per tatimpaguesit e tjere.

**Neni 131**
**Veprat penale**

1) Person, i cili, për çdo tatim të vendosur nga një ligj tatimor, kryen ndonjërën nga veprat që vijojnë, dënohet ne perputhje me Kodin Penal kur:

a) me dashje përpiqet të kryejë evazion tatimor;
b) me dashje nuk mbledh tatimin ose nuk paguan tatimin në buxhet;
c) me dashje fsheh ose shkatërron libra dhe regjistrime, dokumente, deklarata ose informacion tjetër të rëndësishëm për detyrimin tatimor;
d) me dashje dorëzon dokumente, deklarata tatimore ose informacion të falsifikuar;
e) me dashje nuk i bindet një kërkese me shkrim për t'u paraqitur në organet tatimore;
f) me dashje ndërhyn në vlerësimin ose mbledhjen e tatimit;
g) kërcënon ose kryen shkelje kundër një zyrtari tatimor;
h) në bashkepunim me një zyrtar tatimor, paguan ose pranon rryshfete;
i) i ofron rryshfet një zyrtari tatimor; ose
j) me dashje jep informacion tatimor në mënyrë të paautorizuar me ligj ose rregullore.

2) Administrata tatimore bën kallezim penal në Prokurori për çdo shkelje të parashikuar në paragrafin e pare të këtij neni.

**Neni 132**
**Ndjekja e dyfishte**

1) Vendosja e dënimit administrativ sipas këtij ligji ose ligji tjetër tatimor nuk e ndalon administratën tatimore për të paraqitur kallezim penal në Prokurori për vepra penale tatimore.

2) Përfundimi i një çeshtjeje penale kundër tatimpaguesit nuk ndalon vendosjen për të njëjtin tatimpagues të një dënimi administrativ sipas këtij ligji ose ligji tjetër tatimor.

**KREU XV**

## DISPOZITA TRANZITORE DHE TE FUNDIT

### Neni 133
### Efekti në detyrimet tatimore dhe vlerësimet ekzistuese

1) Me hyrjen ne fuqi te ketij ligji, zbatohen dispozitat e parashikuara ketu, per te gjitha procedurat e mbetura me qellim mbedhjen e detyrimeve tatimore.

### Neni 134
### Komisioni i apelimeve tatimore

1) Brenda 60 diteve nga miratimi i ketij ligji, perfundojne te gjitha funsionet e komisionit te apelimeve tatimore.

2) 15 pas hyrjes ne fuqi te ketij ligji, komisioni i apelimeve tatimore nuk do te pranoje me depozitimin per shqyrtim te kerkesave te reja.

3) Komisioni i apelimeve tatimore shqyrton te gjitha praktikat e depozituara ne sekretarine e komisionit brenda afatit te parashikuar ne paragrafin e pare te ketij neni.

### Neni 135
### Manuali i zbatimit te ligjit te procedurave tatimore

1) Brenda 6 muajve nga  hyrja në fuqi e ketij ligji, Këshilli i Ministarve, Ministri i Financave dhe drejtori i pergjithshëm i tatimeve ngarkohen me nxjerrejn e akteve nënligjore të parashikuara në këte ligj.

2) Aktet nënligjore botohen edhe në buletinin tatimor.

3) Drejtori i pergjithshem i tatimeve miraton manualet teknike, manualin e vleresimit, investigimit, te sherbimit te tatimpaguesi dhe te masave shtrenguese si dhe manuale te tjera. Manualët botohen në buletinin tatimor dhe janë detyrues për administratën tatimore dhe tatimpaguesit.

4) Ministri i Financave miraton udhezimin e pergjithshem te zbatimit te procedurave tatimore ne Republiken e Shqiperise. Udhezimi publikohet edhe ne buletinin tatimor dhe eshte i detyrueshem per administraten tatimore dhe tatimpaguesit.

5) Buletini tatimor eshte publikimi zyrtar i drejtorise se pergjithshme te tatimeve.

### Neni 136
### Shfuqizime

1) Me hyrjen ne fuqi te ketij ligji, Ligji nr. 8560, datë, 22.12.1999 “Mbi Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij shfuqizohen.

2) Me hyrjen ne fuqi te ketij ligji, ligji nr. 7758, date 12.10.1993 “Mbi dokumentmin dhe mbajtjen e llogarive per tatimet” si dhe aktet nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij, shfuqizohen.

3) Me hyrjen ne fuqi te ketij ligji, çdo dispozite qe bie ne kundershtim me të shfuqizohet.

**Neni 137**
**Hyrja në fuqi**

Ky Ligj hyn në fuqi 15 dite mbas botimit ne Fletoren Zyrtare.

**JOZEFINA TOPALLI**

**KRYETARE E KUVENDIT**